



EU TECHNICAL ASSISTANCE
TO CIVIL SOCIETY ORGANISATIONS
IN THE WESTERN BALKANS AND TÜRKIYE



UDHËZIMET E RISHIKUARA TË DG NEAR
PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE
NË BALLKANIN PERENDIMOR DHE TURQI
2021-2027

Raport vlerësimi i situatës bazë

ANEKSI 1

ANALIZA PËR
SHQIPËRINË



Funded by
the European Union



Ky studim u krye nga një ekip ekspertësh nën mbikëqyrjen e projektit EU TACSO 3

Expertja drejtuese dhe autorja kryesore: Snježana Bokulić

Analistja e të dhënave dhe ekspertja e anketimit: Dr. Blerina Metanj Subashi

Autorët e Analizës për Vendet:

Natasha Mazari – Shqipëri

Kanita Kulić – Bosnje dhe Herzegovinë

Afërdita Pustina – Kosovë

Aleksandra Gligorović – Mali i Zi

Marija Armenski – Maqedonia e Veriut

Jelena Pajović van Reenen – Serbi

Özge Konuralp – Turqi

Drejtuesi i Ekipit EU TACSO 3 – Richard Allen

Këshilltarët Ligjore

Dr. Ersida Teliti – Shqipëri

Selim Kulić – Bosnje dhe Herzegovinë

Milorad Marković MSci – Mali i Zi

Maja Atanasova – Maqedonia e Veriut

Dr. Robert Sepi – Serbi

Assoc. Prof. Dr. Ulaş Karan – Turqi

Redaktori:

Jonathan Boulting

Beograd, Serbi, Maj 2023

<https://tacso.eu>

Hyrje

Analiza për Shqipërinë është një aneks i Udhëzimeve të DG NEAR për Mbështetjen e Shoqërisë Civile 2021-2027: Raport Vlerësimi i Situatës Bazë 2021.

Udhëzimet paraqesin rezultatet që aspiron të ketë mbështetja e BE-së për shoqërinë civile në rajonin e zgjerimit në këtë periudhë 7-vjeçare. Ky vlerësim ofron evidencë për sit Ky aneks ofron një përmbledhje të evidencës për vlerësimin e situatës në Shqipëri kundrejt secilit nga 59 treguesit që janë të përfshirë tek Udhëzimet. Ky aneks duhet të lexohet së bashku me raportin kryesor, i cili gjendet në faqen e internetit tacso.eu.

Metodologjia

Analiza e prezantuar në raportin kryesor dhe në anekset përkatëse është bazuar në të dhëna të mbledhura nga burime parësore dhe dytësore. Kërkimi parësor përfshiu anketat me OSHC-të dhe zyrtarë publikë, si dhe analizën ligjore të ligjeve përkatëse. Burimet dytësore siç janë raportet e prodhura nga OSHC-të, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, qeveria si dhe aktorë të tjerë, u rishikuan për të dhëna dhe informacionet përkatëse. Grumbullimi dhe analiza e të dhënave i referohet vitit 2021, i cili është viti i situatës bazë.

Anketa me zyrtarët publikë u realizua nga 13 tetori deri me 22 nëntor 2022. Qëllimi i anketës ishte të mbledhte informacion për disa nga indikatorët, bazuar në perspektivën e zyrtarëve publikë të përzgjedhur, të cilët në punën e tyre angazhohen më ngushtësisht me OSHC-të. Anketa konsistoi kryesisht me pyetje të mbyllura dhe ishte anonime. Për Shqipërinë, u morën nëntë përgjigje nga institucionet publike.

Anketa me OSHC-të u realizua nga 26 shtatori deri me 18 tetor 2022. Anketa u qarkullua gjerësisht dhe mori 95 përgjigje të vlefshme në Shqipëri. Këto përbënin 12% të të gjithë përgjigjeve nga të shtatë përfituesit e IPAs.

Më shumë se gjysma e atyre që u përgjigjën, 58%, ishin zyrtar të lartë në organizatë, kryesisht drejtorë ekzekutiv, por edhe zyrtarë të tjerë të lartë, anëtarë apo kryetarë bordi. Përsa i përket kohës në organizatë, 55% e tyre kanë qenë me organizatën për tetë vite ose më shumë.

Më shumë se dy të tretat e atyre që u përgjigjën, 71%, u identifikuan si gra; ndërsa 29% u identifikuan si burra. Më shumë se katër të pestat e atyre që u përgjigjën, 88.4%, ishin 31 vjeç ose më shumë; 26% ishin me shumë se 51 vjeç.

Më pak se një e katërta e atyre që u përgjigjën, 17.9%, u identifikuan që i përkasin një komuniteti, minoriteti, ose grupi të marginalizuar. Nga këta që u identifikuan se i përkasin një grupi të tillë, 6% u identifikuan se i përkasin një komuniteti rural, 5.9% Roma, Ashkali ose Egjiptian, dhe i njejtë numër, 5.9%, grupit të grave të dhunuara.

Më shumë se dy të tretat e OSHC-ve pjesëmarrëse, 72.8%, janë krijuar gjatë dy dekadave të fundit; 34.8% e tyre nga 2011-2021. Vetëm 3.3% e OSHC-ve pjesëmarrëse janë krijuar në 1990 ose më heret.

Virtualisht, të gjithë përgjigjet, 98.9%, ishin nga organizata të regjistruara formalisht. 32.5 e OSHC-ve pjesëmarrëse ishin regjistruar si shoqata qytetarësh; 17.5% janë fondacione.

Dy të tretat e OSHC-ve pjesëmarrëse, 63%, punojnë në nivel lokal, në nivel qarku, ose në nivel kombëtar: 29% janë organizata lokale. 23.5%, punojnë brenda dhe jashtë vendit.

Pjesa më e madhe e OSHC-ve që morën pjesë në anketë, 24.1%, punojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe mjedisit dhe klimës, pasuar nga zhvillimi social-ekonomik me 24%; mobiliteti rinor 22.8%; përfshirja sociale 19%; dhe arsimi, kërkimi dhe novacioni me 15.2%.

Më shumë se gjysma e OSHC-ve pjesëmarrëse, 72.8%, janë organizata të vogla me 1-10 staf dhe vullnetarë të përhershëm, me kohë të plotë ose të pjesshme, që punonin në kohën e anketimit. Vetëm 2.5% e OSHC-ve pjesëmarrëse angazhojnë 51 ose më shumë staf dhe vullnetarë. 10% e të anketuarve thanë se organizata e tyre ka një xhiro vjetore deri në 25,000 euro. 19% e tyre thanë se xhiroja vjetore e organizatës së tyre është midis 100,001 dhe 500,000 euro, ndërsa 2.5% thanë se xhiroja vjetore e organizatës së tyre e kalon 500,000 euro.

Vlerësimi kundrejt treguesve

Të dhënat e mbledhura u përdorën për analizën e situatës në 2021 kundrejt secilit tregues. Për treguesit që kanë një vlerësim normativ, si përputhja me legjislacionin ose standardet, është përdorur sistemi i mëposhtëm i dritës së semaforit, për të dhënë një udhëzim të shpejtë vizual:

5 – plotëson të gjithë standardet

4 – plotëson shumicën e standardeve

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar

2 – plotëson standardet minimalisht

1 – nuk i plotëson standardet

Ky lloj vlerësimi u aplikua për treguesit ku vlerësimi dukej se kishte kuptim.

Treguesit e mbetur nuk kanë standard normativ, por tregojnë trendin vit-pas-viti. Kështuqë raportet e ardhshme të vlerësimit do të ofrojnë vlera krahasuese kundrejt situatës bazë 2021.



Objektivi Specifik 1

Ka një mjedis mundësues për shoqërinë civile për të realizuar aktivitetet e saj.

OS 1.1. Të gjithë individët dhe subjektet juridike në rajonin e zgjerimit mund të krijojnë, të bashkohen dhe të marrin pjesë në organizatat jo-formale dhe/ose të regjistruara, mund të mblidhen dhe të shprehen lirisht.

Treguesi 1.1.a: Masa në të cilën legjislacioni kombëtar përkatës mundëson që:

- Shoqatat mund të krijohen ose regjistrohen pa asnjë lloj diskriminimi;
- Nuk ka kufizime të paligjshme për gamën e aktiviteteve ose arritjen e objektivave të tyre;
- Shpërndarja e tyre mund të ndodhë vetëm pas një vendimi nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme;
- Nuk ka kufizime të paligjshme për lirinë e tubimit paqësor;
- Liria e shprehjes ushtrohet nga të gjithë dhe nuk ka kufizime të paligjshme.

4 – plotëson shumicën e standardeve

61–80

Liria e organizimit është e garantuar nga Kushtetuta, Neni 46¹. Gjithashtu, Kodi Civil² i cili është aprovuar në 1994 siguron lirinë e organizimit dhe krijimit të subjekteve ligjore private si shoqatat, fondacionet, qendrat dhe subjekte të tjera private, të krijuara sipas ligjit. OSHC-të e para në Shqipëri u krijuan bazuar në Kodin Civil, sepse para vitit 2001 nuk kishte një ligj për OSHC-të.

Krijimi, regjistrimi, funksionimi, organizimi dhe aktiviteti i OSHC-ve është rregulluar nga Ligji “Për Organizatat Jo-fitimprurëse” (No. 8788, datë 07/05/2001). Sipas këtij ligji, OSHC-të përfshijnë: (1) organizata me anëtarësi me të paktën pesë persona ose dy subjekte ligjore si anëtarë themelues dhe një asamble të përgjithshme si struktura më e lartë vendim-marrëse; dhe (2) fondacionet dhe qendrat të cilat mund të krijohen nga një ose më shumë persona ose me testament dhe që kanë një bord drejtorësh si strukturën më të lartë vendim-marrëse³.

Sidoqoftë, në 2021 është aprovuar Ligji no. 80/2021 “Mbi regjistrimin e organizatave jo-fitimprurëse”⁴ që përcakton procedurat për regjistrimin e OJF-ve dhe rregullat për menaxhimin e regjistrimit të OJF-ve, të cilat janë të detyruara të regjistrohen sipas legjislacionit, i cili përcakton rregullat për krijimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe aktivitetin e tyre. Ligji parashikon një regjistrim të centralizuar për OSHC-të vetëm në Gjykatën e Shkallës së Parë në Tiranë.

Formalisht, Ligji “Mbi regjistrimin e organizatave jo-fitimprurëse” ka vendosur një procedurë të thjeshtë dhe të qartë dhe nuk vendos ndonjë pengesë ligjore për regjistrimin e OSHC-ve. Ai nuk kërkon ndonjë fond themelues për regjistrimin dhe vendos një afat ligjor prej 15 ditësh midis kërkesës për regjistrim dhe vendimit që e formalizon atë. Sidoqoftë, në praktikë, Neni 7 i ligjit e cakton Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës si institucionin e vetëm kompetent për të gjithë procedurat e regjistrimit dhe shpërndarjes së OSHC-ve, çfarë vendos një barrë të madhe administrative dhe financiare mbi OSHC-të, sidomos OSHC-ve të reja jashtë Tiranës. Vendimet për regjistrimin e organizatave jo-fitimprurëse, si dhe çdo vendim tjetër i lidhur me veprimet lidhur me regjistrimin e tyre, merren nga një gjyqtar i vetëm i seksionit

1 Ky Nen nuk është amenduar që nga 1998, kur është aprovuar.

2 Këto jepen nga Kodi Civil, Nenet 24 – 63.

3 Udhërrëfytyesi për politikën qeverisëse drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019–2023, Qeveria e Shqipërisë, f. 31, 2019.

4 Ligji gjendet në: <https://qaz.gov.al/eli/ligj/2021/06/24/80>

tregëtar të gjykatës bazuar në kërkesën e subjektit të interesuar. Afati ligjor prej 15 ditësh rrallë zbatohet në praktikë, justifikuar me ngarkesën e madhe të gjyqtarëve me çeshtje të tjera.

Procedurat e centralizuara të regjistrimit, të kombinuara me mungesën e një sistemi efektiv elektronik të regjistrimit, bëjnë që OSHC-të të udhëtojnë për në Tiranë disa herë për të ndjekur kërkesën për regjistrim ose ndryshime në aktet e tyre apo për çregjistrim. Kosto e lartë financiare për regjistrim, procedurat e gjata dhe koha e udhëtimit si dhe mungesa e profesionistëve të specializuar në çeshtjet ligjore të OSHC-ve, mund të krijojnë barriera të panevojshme për OSHC-të e vogla (*grassroots*) jashtë Tiranës, të cilat nuk kanë një financim fillestar dhe i shohin kostot e procesit të regjistrimit të papërballueshme dhe dekurajuese⁵.

Për më tepër, Ligji no. 80/2021 paraqet disa sfida për operimin e lirë të organizatave, si: - Nivel i lartë i gjobave për shkeljet administrative, në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe me kuadrin ligjor në fuqi; - Mungesa e procedurës për çregjistrimin e OJF-ve në gjykatë dhe para autoritetit përgjegjës për procesin, në rastet kur OJF-të nuk janë regjistruar në taksa-tatime. Kështu, ligji plotëson standardet minimalisht. Sidoqoftë, zbatimi i ligjit të ri nuk filloi në 2021 dhe OSHC-të vazhduan të regjistrohen sipas ligjit të vjetër të 2001.

Liria e tubimeve paqësore garantohet nga Kushtetuta, Neni 47. Gjithashtu, Ligji no. 8773, datë 23.4.2001. "Për tubimet", Neni 1, paragrafi 1 thotë: Në Republikën e Shqipërisë, çdo person ka të drejtë të organizohet dhe të marrë pjesë në tubime paqësore dhe të paarmatosura. Kështu, e drejta e tubimit paqësor është një e drejtë për çdo njeri, sipas kërkesave të ligjit. Sidoqoftë, gjatë pandemisë së Covid 19, u aprovuan shumë akte normative të adoptuara nga Këshilli i Ministrave, me të njëjtën fuqi ligjore sikurse ligji. Këto akte kufizuan lirinë e tubimit paqësor, nganjëherë edhe i ndaluan ato. Kështu, në 2021, Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) nxori 19 akte, amendoi Urdhërin no. 633, datë 17.11.2020, "Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura", si një masë parandaluese në kushtet e pandemisë COVID-19, duke vendosur kufizime në të drejtën e tubimeve paqësore⁶.

Ligji no. 8773, datë 23.4.2001, "Për tubimet" kufizon lirinë e tubimit paqësor në këto raste: kur siguria kombëtare është në rrezik, për sigurinë publike, mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, ruajtjen e shëndetit ose moralit ose mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Për arsye të ndikimit në shoqëri, në rastet kur tubimet paqësore kanë përfunduar me armë dhe njerëz të plagosur, ndalimi i një tubimi është theksuar edhe më shumë në Nenin 8⁷ mbi 'Ndalimin e zhvillimit të një tubimi', kur ka arsye të justifikueshme se zhvillimi i një tubimi në një shesh publik ose rrugë përbën një rrezik real për sigurinë kombëtare, sigurinë publike, parandalimin e krimit, ruajtjen e shëndetit ose moralit ose mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve dhe ky rrezik nuk mund të ndalohet me masa të tjera më pak detyruese, shefi i policisë mund të ndalojë tubimin ose të vendosë për kohën dhe vendin e tubimit.

Kodi Penal është amenduar duke njohur të drejtën e tubimit pa kërkuar leje (vetëm me njoftim) prej policisë së shtetit, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Liria e grumbullimit nuk është subjekt i ndonjë formaliteti ose aprovimi nga policia, por për ushtrimin e kësaj të drejte, sipas Ligjit no. 8773/2001, kërkohet vetëm të bëhet një njoftim tek policia në një kohë të caktuar.

Në Nenin 22, Kushtetuta shqiptare afirmon lirinë e shprehjes si një nga të drejtat e njeriut më të rëndësishme. Ajo është e lidhur ngushtë me të drejtën për informim, Neni 23. Gjithashtu, Ligji no. 8239, datë 03.09.1997, "Për median", ka vetëm një nen që thotë "shtypi është i lirë". Liria e shtypit mbrohet me ligj. Ligji no.97/2013 "Për median audio-vizuale në Republikën e Shqipërisë"⁸ rregullon aktivitetin e medias audio-vizuale dhe shërbimet mbështetëse, bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Më tej, në Kodin Penal, në nenin 261, thuhet se veprimet që pengojnë qytetarët nga ushtrimi i të drejtës së shprehjes, grumbullimit apo manifestimit përbën një krim dhe dënohet me gjobë ose deri në 6 muaj

5 Udhërrëfytyesi për politikën qeverisëse drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019–2023, Qeveria e Shqipërisë, f. 32, 2019.

6 <https://partnersalbania.org/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-OSHCs-development-country-report-for-albania-2021/>, p. 11.

7 https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2016/01/Ligj_nr.8773_23.4.2001_Per_tubimet.pdf

8 <https://qbz.gov.al/eli/liqj/2013/03/04/97-2013>

burg. Kur veprimet shoqërohen me përdorimin e forcës fizike ato janë të dënueshme me gjobë ose deri në tre vite burg.

Sipas Kushtetutës, liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në dy raste: për interes publik dhe për të mbrojtur të drejtat e njeriut të tjerëve.

Kuadri ligjor dhe rregullator për të drejtën e grumbullimit, organizimit dhe shprehjes është në përgjithësi në përputhje me standardet ndërkombëtare..

OS 1.2. Autoritetet publike mbrojnë OSHC-të nga ndërhyrjet dhe sulmet dhe respektojnë të drejtën e tyre të privatësisë.

Treguesi 1.2.a: Masën në të cilën OSHC-të kanë mundësinë e një ndërhyrje efektive për të sfiduar ose kërkuar rishikimin e vendimeve që prekin ushtrimin e të drejtave të tyre.

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar 41–60

Kuadri ligjor në Shqipëri ju jep të drejtë OSHC-ve të përdorin mekanizma ligjor për të sfiduar ose kërkuar rishikimin e vendimeve që prekin të drejtat e tyre. Kështu, OSHC-të kanë të drejtë të ankohen në gjykatë për çështje civile, administrative dhe penale. Në 2021, OSHC-të draftuan ligjin “Mbi padinë kolektive”, si një rrugë për OSHC-të për të mbrojtur interesat kolektive. Ky projekt ligj synon të krijojë një instrument të ri ligjor, “padinë kolektive”, që lehtëson aksesin e qytetarëve në drejtësi dhe ndalon sjelljen e paligjshme nga disa operatorë, siç janë entitetet që operojnë në fushën e industrisë, telekomunikacioneve, tregëtisë dhe shërbimeve të tjera. Sidoqoftë, projekt-ligji nuk u aprovua në 2021.

Më tej, OSHC-të mund të licensohen nga Ministria e Drejtësisë për të ofruar Ndihmë Ligjore Falas (të parë ose të dytë) për OSHC-të dhe individët. Gjithashtu, e drejta për informim dhe konsultime publike ju njihet edhe OSHC-ve. Këto ligje mund të lehtësojnë punën e OSHC-ve për të kërkuar rishikimin e vendimeve që ndikojnë në mënyrën se si ato operojnë.

Kuadri legjislativ aktual afirmon të drejtën e OSHC-ve për rishikim efektiv, kështu që, në përgjithësi, standardet e të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë plotësuar. Sidoqoftë, në praktikë, ka pengesa si tejzgjatja e procedurave.

Çështjet administrative të lidhura me Zyrën e Taksave ose Sigurimet Shoqërore zgjasin shumë dhe krjojnë vështirësi në ndjekjen e tyre.

Më tej, bazuar në anketën e OSHC-ve, 79% e të anketuarve thanë se qeveria nuk ka marrë vendime mbi organizatat e tyre që ndikojnë negativisht në aftësinë e tyre për të ushtruar të drejtat. Nga ana tjetër, 13% e të anketuarve thanë po, qeveria ka marrë vendime mbi organizatat e tyre që ndikojnë mbi aftësinë e tyre për të ushtruar të drejtat. Disa nga vendimet që ka marrë qeveria ishin:

- Ligji No. 112/2020, që hyri në fuqi në 2021 për regjistrimin e pronarëve përfitues, sipas të cilit OSHC-të ishin të detyruara të regjistroheshin në Qendrën Kombëtare të Biznesit edhe pse nuk ishin biznese, me kosto të papërbalueshme regjistrimi, në formën e nënshkrimit elektronik si një kosto që përsëritet çdo vit. Kështu, disa organizata ishin detyruar të kontaktonin & paguanin një ekspert të një pale të tretë për të plotësuar këtë kërkesë.
- Për shkak të mungesës së kapacitetit të stafit të zyrës së taksave, disa organizata ishin ngarkuar me detyrime financiare që krijuan vështirësi për këto organizata për të aplikuar për projekt propozime, për shkak të kriterëve formale të donatorëve që pranojnë aplikime për grante nga organizatat që nuk kanë ndonjë vendim në pritje nga autoritetet e taksave.

Bazuar në anketën e OSHC-ve, 50% e të anketuarve nga 13% që ishin ndikuar negativisht nga vendimet e qeverisë, thanë se ata nuk e sfiduan apo kërkuan një rishikim të vendimit të qeverisë dhe vetëm 37% e atyre që janë ndikuar negativisht thanë se ata kërkuan një rishikim të vendimit të qeverisë. 6% të 37% të OSHC-ve që kërkuan rishikim thanë se ata ishin të pamundur të sfidojnë efektisht vendimet që kishin ndikim negativ mbi ta. Është e vështirë për OSHC-të të sfidojnë ose kërkojnë të rishikojnë vendimet që prekin ushtrimin e të drejtave të tyre për shkak të kostove financiare dhe mungesës së ekspertizës ligjore.

Treguesi 1.2.b: Masa në të cilën OSHC-të janë të mbrojtura me ligj kundrejt kërcënimeve, sulmeve, ngacmimeve ligjore dhe trajtimit diskriminues, në veçanti:

- Kërcënimet përfshirë intimidimin, ngacmimin, shpifjen, si dhe gjuhën e urrejtjes drejtëpërdrejt dhe online;
- Sulmet përfshirë aktet e dhunës, abuzimit fizik, kontrollit dhe dëmtimit të pronës;
- Ngacmimi juridik përfshirë arrestimin ose ndalimin arbitrar, ndërhyrjen e paligjshme në komunikime, abuzimin me procedimet dhe kërcënimet penale, civile dhe administrative;
- Trajtimi diskriminues përfshirë kërkesat jo-proporcionale të raportimit për OSHC-të.

5 – plotëson të gjithë standardet | 81-100

Kuadri ligjor përfshirë Kodin Civil, Kodin Penal dhe Ligjin no. 9754, datë 14.6.2007, “Për përgjegjësinë penale të personave juridik”, përcakton rregullat lidhur me përgjegjësinë, procedimet penale dhe tipet e masave të dënimit që janë ndërmarrë kundër personave juridik në rastin e kryerjes së veprave penale nga persona fizik.

Kështu, Kodi Penal thekson në Nenin 121/a Përndjekja: Kërcënimi ose ngacmimi i personave nëpërmjet veprimeve të përsëritura me qëllim shkaktimin e një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë të ankthit ose frikës për sigurinë e tyre personale, ose i një të afërmi ose personi me të cilin ai/ajo ka lidhje shpirtërore, ose ta detyrosh atë të ndryshojë menyrën e tij/saj të jetesës, dënohet me burg nga 6 muaj deri në katër vjet.

Ligji no. 10 221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen kundër diskriminimit”, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mos-diskriminimit përsa i përket racës, etnisë, ngjyrës, gjuhës, shtetësisë, besimeve politike, fetare apo filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore apo shoqërore, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, karakteristikave seksuale, mënyrës së jetesës më HIV/AIDS, shtatëzanisë, prindërimit, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare apo martesore, vendbanimit, gjendjes shendetësore, predispozitave gjenetike, pamjes së jashtme, paaftësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar, ose për çdo arsye tjetër.

Dispozitat e mësipërme janë dhënë në përgjithësi, për tipet e ndryshme të personave/subjekteve juridik ose për organizatat. Kodi Penal është akti ligjor me fuqi të përgjithshme dhe shtrin efektin e tij mbi çdo person juridik që është krijuar ose funksionon në Republikën e Shqipërisë. Kodi Civil është një akt tjetër që legjitimon OSHC-të, sikurse subjektet e tjera, të kërkojnë kompensim për dëmtimet jo-kontraktuale. Përveç kësaj, ligji “Për mbrojtjen kundër diskriminimit” është në përgjithësi i orientuar drejt personave fizik, por disa nga nenet ju referohen personave juridik.

Rrjedhimisht, të gjithë aktet duhet të interpretohen në një mënyrë të gjërë në mënyrë që të ofrojnë mbrojtje dhe të jenë të aplikueshme për OSHC-të.

Legjislacioni shqiptarë e ka të rregulluar në përgjithësi veprën penale të kërcënimit.

Nuk ka një dispozitë specifike për sulmet kundër OSHC-ve. Gjithashtu, në këtë rast, ligjvënësi ka vendosur që të konsiderohen në kuadrin e dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal. Sidoqoftë, dispozitat e Kodit Penal dhe Civil mund të aplikohen për OSHC-të.

Kështu, bazuar në analizën e mësipërme, nuk ka një kuadër ligjor të vecantë për mbrojtjen e OSHC-ve në Shqipëri nga kërcënimet, sulmet, ngacmimet ligjore dhe trajtimin diskriminues. OSHC-të janë subjekte sikurse personat fizik që mund të sigurojnë të drejtat e tyre nga dispozitat e përgjithshme.

Treguesi 1.2.c: Pjesa e OSHC-ve që operojnë efektivisht, pa kërcënime, sulme, ngacmime juridike dhe trajtim diskriminues, në kuptimin e:

- Numrit të ankesave për mungesën e mbrojtjes për OSHC-të;
- Numrin e sulmeve mbi OSHC-të dhe anëtarët e tyre;
- Numrin e rasteve të dëmtimit të pronës;
- Numrin e rasteve të trajtimit diskriminues në raportim;
- Numrin e rasteve kur zyrat e OSHC-ve janë kontrolluar në mënyrë të paligjshme, në kuadrin e inspektimeve;
- Numrin e rasteve të ndërhyrjes në komunikimet e OSHC-ve.

Bazuar në rezultatet e anketës së OSHC-ve, 92% e të anketuarve thanë se organizata e tyre ose anëtarët e tyre nuk kanë qenë subjekt i kërcënimeve apo sulmeve fizike. Kurse 3% thanë se kanë qenë subjekt i kërcënimeve apo sulmeve fizike.

Ata që u përgjigjën që organizatat e tyre ose anëtarët e tyre kanë qenë subjekt i kërcënimeve apo sulmeve fizike ishin organizata që punojnë me viktimat e dhunës në familje. Ata përmendën se stafi i tyre është kërcënuar nga ushtruesit e dhunës në familje. Gjithashtu, disa nga anëtarët e tyre janë kërcënuar online në mediat sociale. 2% e OSHC-ve kanë bërë një ankëse zyrtare sepse atyre iu është mohuar mbrojtja nga kërcënimet apo sulmet fizike.

Më tej, 97% e të anketuarve pohuan që organizata e tyre nuk ka përjetuar dëmtim të pronës në kuadrin e kërcënimeve dhe sulmeve fizike kundër tyre. Sidoqoftë ishte një përqindje e vogël e OSHC-ve (3%) që kishin përjetuar dëmtim të pronës në kuadrin e kërcënimeve dhe sulmeve fizike kundër tyre.

90% e të anketuarve thanë që organizatës së tyre nuk iu ishte kërkuar nga autoritetet që të dorëzonin ndonjë raport të tepruar dhe të pajustificuar që do ta bënte trajtimin diskriminues. Sidoqoftë, 5% thanë se organizatës së tyre iu ishte kërkuar nga autoritetet që të dorëzojnë raporte të pajustificuara. Në këto raste, organizatat konsiderojnë ligjin No. 112/2020 “Për regjistrimin e pronarëve përfitues” si një veprim të tepruar, sepse sipas disa OSHC-ve, ata ishin detyruar të regjistroheshin në Qendrën Kombëtare të Biznesit edhe pse nuk ishin biznese.

Pothuaj të gjithë të anketuarit (98%) thanë se zyrat e tyre nuk kanë qenë subjekt i kontrolleve apo inspektimeve të paligjshme dhe 92% thanë se autoritetet nuk kanë ndërhyrë në komunikimet e organizatës së tyre; ndërsa 5% thanë që autoritetet kanë ndërhyrë në komunikimet e organizatës së tyre.

OS 1.3. Masat e përdorura për të luftuar ekstremizimin, terrorizmin, pastrimin e parave, dhe korrupsionin janë të targetuara dhe proporcionale, në përputhje me qasjen e bazuar tek rreziku, dhe respektojnë standardet e të drejtave të njeriut mbi lirinë e organizimit, tubimit dhe shprehjes.

Treguesi 1.3.a: Masa në të cilën ligjet për të luftuar ekstremizimin, terrorizmin, pastrimin e parave, dhe korrupsionin nuk kufizojnë në mënyrë të padrejtë aktivitetet legjitime të OSHC-ve.

4 – plotëson shumicën e standardeve

61–80

Ekstremizimi, terrorizmi, pastrimi i parave, dhe korrupsioni janë vepra penale në Shqipëri dhe dënohen me ligj. Bazuar në hierarkinë ligjore, Kodi Penal i parashikon të gjitha këto vepra penale. Kuadri ligjor për këto vepra penale është i përbërë nga shumë ligje përfshirë:

- Ligjin no. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, i amenduar disa herë, për herë të fundit me no.120/2021, datë 2.12.2021.
- Ligjin no. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.
- Ligjin no. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Lidhur me ekstremizimin, qeveria shqiptare ka adoptuar Vendimin no. 930, datë 18.11.2015, “Për aprovimin e strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit kundër ekstremizimit të dhunshëm”. Shqipëria, për të forcuar legjislacionin kombëtar, ka ratifikuar një seri konventash lidhur me këtë fenomen. Sidoqoftë, legjislacioni nuk është i qartë dhe disa herë nuk bën dallimin midis bizneseve dhe OSHC-ve. Konfuzioni është në terminologji dhe në konceptin mbi aktivitetet dhe organet qeverisëse.

Më tej, Ligji no. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse” ishte në përgjigje të rekomandimeve të Raportit MONEYVAL “Kundër-paraja dhe masat për financimin e kundër-terrorizmit, rauti i 5-të i Raportit të Përbashkët të Vlerësimit”, i cili kërkoi vendosjen e një regjistri elektronik për OJF-të. Sidoqoftë, regjistri nuk ishte krijuar në 2021, kështu që OJF-të ishin të detyruara të dërgonin vetë informacionin mbi ta nga gjykata tek Qendra Kombëtare e Biznesit.

Dispozitat e mësipërme përfshijnë sidomos subjektet juridike, por duke qenë se OSHC-të janë të përfshira këtu, këto dispozita rregullojnë aktivitetin e tyre dhe janë të detyrueshme për ta. Ata vendosin detyrime mbi autoritetet që regjistrojnë, licensojnë, ose mbikqyrin aktivitetin e OSHC-ve të raportojnë menjëherë tek autoritetet përgjegjëse në se ka dyshime të pastrimit të parave. Sidoqoftë, në disa raste, kufizimet janë vendosur për personat juridik, përfshirë OSHC-të, edhe pse dispozitat janë vendosur vetëm për bizneset.

*“Në 2021, filloi puna për përgatitjen e Metodologjisë së Vlerësimit të Rrezikut rreth Financimit të Terrorizmit për OJF-të, në vazhdim të një serie të inisiativave ligjore që ndikojnë në veprimtarinë e OJF-ve, përfshirë këtu Ligjin mbi pronarët përfitues, regjistrin qendror të llogarive bankare, dhe ligjin e ri të regjistrimit të OJF-ve. Inisiativa është pjesë e përgjigjes ndërkombëtare të OJF-ve për të mbrojtur hapësirën civile dhe menjanuar mbi-rregullimin e OJF-ve në emër të Masave Kundër Pastrimit të Parave/Financimit të Terrorizmit, në përputhje me Rekomandimin 8 të FATF mbi OJF-të. Qëllimi i metodologjisë është të ndihmojë kuptimin e rrezikut të TF në sektorin e OJF-ve, të vlerësojë sa efektisht janë menaxhuar rreziqet dhe të mundësojë ata të demonstrojnë sa e kanë kuptuar këtë”.*⁹

⁹ file:///C:/Users/Admin/Downloads/Partners%20Monitoring%20Matrix%20Report_2021.pdf p. 10.

Treguesi 1.3.b: Proporcioni i OSHC-ve, aftësia e të cilave për të ndërmarrë aktivitete legjitime nuk është kufizuar nga zbatimi i ligjeve për luftën kundër ekstremizmit, terrorizmit, pastrimit të parave dhe korrupsionin, vecanërisht nga:

- Ngacmim juridik për lidhjen e tyre të supozuar me ekstremizmin, terrorizmin, pastrimin e parave, dhe korrupsionin;
- Kufizime diskriminuese të vendosura mbi financimin;
- Autoritetet ose bankat që parandalojnë ata të hapin llogari bankare, të dergojnë apo marrin para.

Pothuajse të gjitha OSHC-të pjesëmarrëse (98%) thanë në anketë se as organizatat e tyre dhe as anëtarët e tyre nuk kane qenë subjekt i ngacmimit juridik për lidhjen e tyre të supozuar me ekstremizmin, terrorizmin, pastrimin e parave, ose korrupsionin. Vetëm 2% e OSHC-ve thanë se anëtarët e tyre ishin subjekt i ngacmimit juridik.

Gjithashtu, rreth 95% e të anketuarve thanë se organizata e tyre nuk ka qenë subjekt i kufizimeve diskriminuese si pasojë e marrjes së fondeve nga burime specifike, ndryshe nga 5% që thanë se organizatat e tyre kanë qenë subjekt i kufizimeve diskriminuese si pasojë e marrjes së fondeve nga burime specifike.

E njëjta përqindje (95%) konfirmuan se organizata e tyre nuk ishte parandaluar nga autoritetet qeveritare ose bankat për të hapur një llogari bankare apo për të derguar ose marrë para. Pjesa tjetër—rreth 5%—përmendën se ata nuk mundën të hapin një llogari bankare sepse organizata e tyre nuk ishte regjistruar në regjistrin e pronarëve përfitues.

OS 1.4. Autoritetet publike trajtojnë të gjithë OSHC-të në mënyrë të barabartë lidhur me operimet e tyre dhe njësoj si subjektet e tjera (si bizneset për shembull).

Treguesi 1.4.a: Masa në të cilën Ligjet (1) nuk ju kërkojnë OSHC-ve të dorëzojnë më shumë raporte dhe informacion dhe (2) nuk i bëjnë OSHC-të subjekt të më shumë inspektimeve dhe sanksioneve se sa subjektet e biznesit, ndërkohë që çdo gjë tjetër është e barabartë.

4 – plotëson shumicën e standardeve

61-80

Ka një seri ligjesh që rregullojnë kërkesat për OSHC-të për të dorëzuar raporte dhe informacion tek autoritetet, përfshirë Ligjin no. 80/2021, “Mbi regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, i cili përmban nene të përgjithshme që detyrojnë OSHC-të të dorëzojnë informacionin dhe të dhënat në gjykatë, dhe Ligji no. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve **përfitues**”. Sidoqoftë, ka shumë ligje dhe akte nën-ligjore që përcaktojnë në mënyrë strikte përgjegjësitë administrative, civile dhe penale dhe sanksionet respektive për mos-respektimin e afateve të raportimit tek autoritetet publike.

Sipas legjislacionit aktual, OSHC-të janë të detyruara të dorëzojnë informacion tek Zyra e Taksave dhe Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave. Lidhur me sanksionet, në 2021, sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave, 14 gjopa janë vënë për OSHC-të për shkelje të ndryshme, të paspecifikuara të ligjit.

Ligji no. 112/2020 “Për regjistrin e pronarëve përfitues” përcakton që Qendra Kombëtare e Biznesit është institucioni përgjegjës për regjistrin. Ky nen krijon konfuzion, pasi OSHC-të e fitojnë personalitetin juridik nëpërmjet vendimeve të gjykatës, ndërsa kompanitë e fitojnë personalitetin juridik nëpërmjet regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në mënyrë që të jetë në rregull me regjistrin e pronarëve përfitues, OSHC-të duhet të regjistrohen në dy institucione të ndryshme (në Gjykatë dhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit).

Kuadri ligjor detyron OSHC-të të dorëzojnë raporte dhe informacion tek autoritetet si bizneset. Në parim, kërkesat e përmendura më sipër janë si për OSHC-të ashtu edhe për bizneset. Për rrjedhojë nuk ka ndryshim midis OSHC-ve dhe bizneseve lidhur me inspektimet dhe sanksionet. Sidoqoftë, në rastin e OSHC-ve, për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe njerëzore, barra e këtyre detyrimeve financiare është më e madhe. Gjithashtu, zyra e taksave nuk është akoma plotësisht e ndërgjegjësuar për rregullat dhe procedurat që rregullojnë marrdhëniet midis OJF-ve dhe donatorëve të tyre. Në praktikë, në 2021, rimbursimi i TVSH-së për OSHC-të nuk ishte një proces i lehtë.

OS 1.5. Autoritetet publike qendrore dhe/ose lokale kanë politika dhe rregulla mundësuese për organizatat e vogla komunitare dhe iniciativat qytetare (organizatat grass-roots).

Treguesi 1.5.a: Organizatat e vogla/lokale komunitare dhe iniciativat qytetare lejohen të operojnë ligjërisht pa u regjistruar.

5 – plotëson të gjithë standardet 81–100

Bazuar në kuadrin ligjor shqiptar, çdo person ka të drejtën e një organizate kolektive, pa pasur nevojë të regjistrohet si organizatë jofitimprurëse. Ata mund të aplikojnë për projekte, menaxhim grantesh, dhe aktivitete të tjera të lidhura me detyrimet e tjera që lindin nga legjislacioni mbi taksat. Sidoqoftë, ata nuk mund të marrin fonde publike.

Legjislacioni shqiptar njeh të drejtën ligjore të komuniteteve ose grupeve jo-formale që të jenë aktiv në jetën shoqërore, të ndërmarrin aktivitete legjislativë (si për shembull referendume lokale) dhe të luftojnë kundër fenomeneve negative. Ligje specifike dhe Kodi Elektorale kanë nene specifike lidhur me të drejtën për referendume lokale. Funksionimi i këtyre grupeve nuk lidhet me numrin dhe madhësinë e grupeve informale/komunitare por me aktivitetet e tyre.

Ligji no. 139/2015, “Mbi vetëqeverisjen vendore”, amenduar me Ligjin no. 38/2019, datë 20.6.2019, përcakton në Nenin 19: Të drejtën e kërkesës, ankesës dhe komentit: “1. Çdo qytetar ose grup qytetarësh që përfaqëson komunitetet ka të drejtë të adresojë kërkesa, ankesa ose komente tek institucionet vetë-qeverisëse për çështje lidhur me funksionet dhe kompetencat nën juridiksionin e njësisë së vetë-qeverisjes vendore. 2. Institucionet e vetë-qeverisjes vendore janë të detyruara të marrin në konsideratë kërkesat, ankesat dhe komentet dhe të kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara nga Ligji.”

Në 2021, është konsultuar draft-Ligji nbi organizimin dhe funksionimin e grupeve lokale të veprimit. Grupet lokale të veprimit janë organizata jofitimprurëse të bazuara në partneritetin, të përbëra nga përfaqësues të interesave social-ekonomike, publike dhe private, ku në vendim-marrje asnjë autoritet publik apo grup interesi nuk ka më shumë se 49% të votave. Qëllimi i ligjit është të fuqizojë pjesëmarrjen e grupeve komunitare në proceset lokale. Ligji pritej që të hynte në fuqi në vitin 2022.

Treguesi 1.5.b: Para ligjit, organizatat e vogla komunitare dhe iniciativat qytetare të peregjistruara gëzojnë të njëjtën të drejtë të pjesëmarrjes në vendim-marrje sikurse OSHC-të e regjistruara.

5 – plotëson të gjithë standardet 81–100

Ligji no.107/2021 “Për bashkëqeverisjen” jep të njëjtën të drejtë për subjektet juridike dhe grupet e interesit, pavarësisht nga forma e tyre e organizimit. Ligji lejon dhe nënvizon pjesëmarrjen e barabartë të qytetarëve dhe grupeve të interesit në të gjithë fazat e procesit të vendim-marrjes. Gjithashtu, Ligji No.119/2015, “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”, garanton të drejtën e pjesëmarrjes së barabartë në të gjithë proceset vendim-marrëse për organizatat e peregjistruara. E njëjta e drejtë është përmendur në Ligjin no. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Për konsultimin publik, faqet zyrtare kanë seksione të veçanta për qytetarët, grupet e interesit dhe ekspertët. Më tej, pjesëmarrja e barabartë e organizatave të peregjistruara dhe iniciativave bëhet sipas Ligjit no. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Nenin 19 dhe 20. Kështu, kuadri ligjor lejon dhe nënvizon pjesëmarrjen e barabartë për qytetarët dhe grupet e interesit në të gjithë fazat e procesit të vendim-marrjes.

OS 1.6. Të gjithë OSHC-të janë të lira të kërkojnë dhe të marrin fonde.

Treguesi 1.6.a: Masa në të cilën ligjet lejojnë OSHC-të të kërkojnë një gamë të gjerë financimi, përfshirë nga jashtë vendit, pa patur kufizime të pajustificuara, lidhur me:

- Donacionet në para apo në natyrë nga të gjithë burimet;
- Financimi nga institucionet publike vendase;
- Financimi nga donatorët institucional, korporativ apo individual;
- Financimi nga qeveritë e huaja apo agjensitë shumë-palëshe.

5 – plotëson të gjithë standardet | 81-100

Ligji no. 8788/2001 “Mbi organizatat jo-fitimprurëse” nënvizon si burime financimi: kuotat e anëtarësisë (për shoqatat), grantet dhe donacionet nga subjekte private ose publike, të vendit ose të huaja, si dhe të ardhurat nga veprimtaria ekonomike dhe asetet e organizatës jofitimprurëse.

Gjithashtu, Ligji përcakton aktivitetin jo-fitimprurës si çdo aktivitet ekonomik ose jo-ekonomik ku të ardhurat ose asetet e organizatës jo-fitimprurëse, në se ka ndonjë, përdoren vetëm për realizimin e qëllimeve të përcaktuara në statutin e organizatës. Kështu, OSHC-të kanë të drejtën e pronës së luajtshme ose paluejtshme dhe të realizojnë të ardhura nëpërmjet administrimit të këtyre pronave si dhe të ushtrojnë aktivitete të tjera, në përputhje me ligjin dhe misionin, sikurse është shprehur në statut. Pra, nuk ka kufizime ose barrë financiare për sigurimin e fondeve nga burime të ndryshme të ligjshme.

Treguesi 1.6.b: Përqindja e OSHC-ve që kanë akses në një gamë të gjërë financimi pa ndërhyrjen e pajustificuar të qeverisë.

92% e OSHC-vë pjesëmarrëse thanë që ata nuk janë ndaluar të aksesojnë ndonjë lloj financimi. Më tej, asnjë nuk u përgjigj që kanë pasur ndonjë ndërhyrje të pajustificuar nga qeveria që ndalon organizatën të aksesojë ndonjë lloj financimi.

OS 1.7. Mbështetja publike financiare dhe jo-financiare për OSHC-të është në dispozicion të përfituesve të IPA-s dhe ajo ofrohet në një mënyrë transparente, të përgjegjshme, të drejtë dhe jo-diskriminuese.

Treguesi 1.7.a: Niveli i financimit publik për OSHC-të dhe shoqatat është rregulluar qartësisht në ligjet dhe rregulloret dhe të drejtat dhe detyrimet e institucioneve shtetërore përgjegjëse për vendosjen dhe rishikimin e nivelit të financimit publik janë përcaktuar qartë në Ligj.

1 – nuk i plotëson standardet

0–20

Niveli i financimit publik nuk është përcaktuar në Ligj. Ai adresohet në politikat publike dhe buxheti planifikohet si i tërë. Agjensia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile/AMSHC mbetet institucioni i vetëm publik që jep mbështetje financiare për shoqërinë civile. Grantet që jep AMSHC për OSHC-të vijnë nga buxheti vjetor i shtetit. Ligji specifikon që shteti nuk mund të caktojë një buxhet më të vogël se buxheti i vitit parardhës për Agjensinë. Sidoqoftë, nuk është e lehtë të dish shumën që jepet për OSHC-të, sepse kjo nuk është përcaktuar në Ligj. Nuk ka një vend specifik ku mund të gjenden të dhënat për financimin e OSHC-ve nga të gjithë ministrinë dhe agjensitë.

Treguesi 1.7.b: Përqindja e buxhetit publik e disbursuar në vit për OSHC-të.

Në 2021, buxheti i shtetit ishte 343,819,922,000 lekë në total, dhe linja e buxhetit – mbështetje për shoqërinë civile - ishte 113.5 milion lekë. Kjo është rreth 0.033 % e buxhetit total publik¹⁰.

Sikurse është përmendur nën Treguesin 1.7.a, AMSHC është institucioni publik kryesor që ofron mbështetje financiare për OSHC-të nëpërmjet financimit publik. Kështu, sikurse është paraqitur në dokumentin 'Matrica e monitorimit mbi mjedisin mundësues për zhvillimin e OSHC-ve, Raporti për Shqipërinë' 2021¹¹, buxheti publik i alokuar për AMSHC-në ishte 90 milion lekë (744,000 euro).

Treguesi 1.7.c: Masa në të cilën kërkesat ligjore që rregullojnë dhënien e fondeve publike për OSHC-të sigurojnë që:

- Kriteret e financimit janë përcaktuar qartë, objektivisht dhe të shpallura publikisht;
- Vlerësimi i propozimeve është i qartë dhe i paanshëm;
- Konflikti i interesit është rregulluar qartësisht;
- Kërkesat e raportimit janë të qarta dhe proporcionale.

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar

41–60

Kuadri ligjor që rregullon dhënien e fondeve publike nuk është i unifikuar. Kështu, çdo institucion publik që jep fonde publike ka kërkesat e tij lidhur me procedurat, menaxhimin dhe kontrollin e këtyre fondeve. Në 2019 është aprovuar rregullorja "Mbi përcaktimin e procedurave dhe rregullave për përzgjedhjen e OSHC-ve të autorizuara të ofrojnë ndihmë ligjore parësore, sikurse garantohet nga shteti, të cilat përfitojnë fonde nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre". Ministria e Drejtësisë aplikon këto kërkesa gjatë përzgjedhjes së OSHC-ve që do të ofrojnë ndihmë ligjore falas. Në 2021, më shumë kërkesa specifike u shtuan për aprovimin e dokumenteve të aplikimit për OSHC-të e autorizuara nga Ministri i Drejtësisë për të përfituar fonde nga buxheti i shtetit.

Grantet nga fondet publike bazohen kryesisht në thirrjet e hapura të nxjerra nga institucionet specifike publike. Jo të gjitha institucionet publike që ofrojnë mbështetje financiare kanë rregulla dhe procedura lidhur me kriteret për fushën e financimit, përzgjedhjen dhe dhënien e grantit. AMSHC bën diferencën

¹⁰ <https://financa.gov.al/buxheti-2021/> tabela-1-Buxheti-2021-institucionet-me-programe-dhe-shpenzimet-e-tjera-1.

¹¹ 'Matrica e monitorimit mbi mjedisin mundësues për zhvillimin e OSHC-ve'. Informacion mbi Shqipërinë, 2021. Partners Albania, Tiranë, Qershor 2022, f 15.

në këtë drejtim. Çdo gjë lidhur me procedurat për grante është publike në faqen e saj të internetit. Agjensia njofton hapur thirrjet dhe jep kohën e mjaftueshme për përgatitjen (më shumë se 30 ditë) dhe dorëzimin e projekt-propozimeve dhe dokumenteve të kërkuara në kuadrin e thirrjes. Në 2021, AMSHC organizoi konsultime me OSHC-të për të përcaktuar fushat prioritare përpara publikimit të thirrjes për propozime.

Kërkesat ekzistuese japin qartë kërkesat e përgjithshme lidhur me konfliktin e interesit në procesin e vendim-marrjes të përfaqësuesve të AMSHC-së, sidomos lidhur me çeshtjet financiare. Gjithashtu, ato përmenden edhe raportet narrative dhe financiare që kërkohen nga OSHC-të që marrin fonde publike. Disa akte shkojnë më tej duke kërkuar dokumente të tjera kur ka dyshime. Dokumentet e raportimit janë pjesë e kontratës dhe OSHC-të janë të informuara lidhur me to kur nënshkruhet kontrata. Institucione të ndryshme kanë kërkesa specifike lidhur me afatet e raportimit që kushtëzojnë afatet e transferimit të fondeve.

Treguesi 1.7.d Qeveria qendrore bën informimin mbi grantet publike që është i mjaftueshëm, i detajuar që të mundësojë identifikimin e granteve individuale.

4 – plotëson shumicën e standardeve | 61–80

Shumica e zyrtarëve qeveritarë thanë se autoritetet përgjegjëse e publikojnë informacionin mbi grantet për OSHC-të në nivelin ‘mjaftueshëm publik’ ose ‘plotësisht publik’.

Në Matricën e Monitorimit për 2021, shkruhet se “*Monitorimi i të gjithë faqeve të internetit të institucioneve publike që kanë ofruar mbështetje financiare për OJF-të në 2021, përfshirë AMSHC-në, tregon se nuk ka raporte vlerësimi mbi ndikimin e fondeve publike të shpërndara për OJF-të. Mungesa e dokumenteve publike në dispozicion lidhur me aksesin në fondet publike, procedurat e kontraktimit dhe monitorimit të tyre, e bën financimin publik për aktivitetin e OJF-vë jo-transparent dhe rrit nivelin e skepticizmit kundrejt shpërndarjes së fondeve publike*”¹².

Treguesi 1.7.e: Pjesa e OSHC-ve që tregon se dhënia e fondeve publike vendase është transparente, e drejtë dhe jo-diskriminuese.

2 – plotëson standardet minimalisht | 21%

Lidhur me fondet publike për OSHC-të, situata duket problematike. Kështu, vetëm 21% e të anketuarve thanë se dhënia e fondeve ishte mjaftueshëm transparente dhe e drejtë. Shumica, 53% e tyre në anketën e OSHC-ve thanë se dhënia e fondeve publike vendase ishte as transparente dhe as e drejtë.

Nga ana tjetër, shumica e zyrtarëve publik të kontaktuar thanë se dhënia e fondeve ishte mjaftueshëm transparente. Në një shkallë më të vogël, zyrtarët publik thanë se procesi ishte mjaftueshëm i drejtë ose shumë i drejtë.

Gjatë diskutimit në grupin fokus, opinioni i përgjithshëm ishte se procesi i dhënies së fondeve publike për OSHC-të nuk ishte mjaftueshëm transparent. OSHC-të hezituan të aplikojnë në kuadrin e thirrjeve për propozime ose ftesave për pjesëmarrje në tendera publik për shërbime të ndryshme për arsye të dyshimeve se procesi nuk do të ishte i drejtë. Gjithashtu, ka raste kur dhënia e fondeve për OSHC-të është vonuar duke krijuar probleme tek OSHC-të në mbulimin e shpenzimeve për aktivitetet.

Institucionet publike nuk ndajnë informacion të plotë me palët e interesuara rreth dhënies së fondeve publike për OSHC-të dhe kjo ka kontribuar në krijimin e një perceptimi se procesi nuk është transparent dhe i drejtë. Kështu, për OSHC-të, nganjëherë bëhet mision i pamundur marrja e të dhënave lidhur me procesin e dhënies së fondeve publike, nga cilat institucione publike tek cilat OSHC, në çfarë shume, e kështu me rradhë.

¹² ‘*Matrica e monitorimit mbi mjedisin mundësues për zhvillimin e OSHC-ve*’, *Informacion mbi Shqipërinë, 2021*, Partners Albania, Tiranë, Qershor 2022, f.16.

Treguesi 1.7.f: Financimi publik nuk përjashton OSHC-të bazuar në grupin që ato përfaqësojnë

Bazuar në anketën e OSHC-ve, përqindja e OSHC-ve që kanë aplikuar për fonde publike ishte 50% dhe përqindja e atyre që nuk kanë aplikuar ishte pothuaj e njejtë, 48%.

77% e atyre që kanë aplikuar për fonde thanë se aplikimi i tyre nuk ishte i suksesshëm. Vetëm 19% thanë se aplikimi ishte i suksesshëm. Ndër arsytet që përmendën ata që thanë se aplikimi i tyre nuk ishte i suksesshëm ishin: konkurrenca ishte shumë e fortë (25%); autoritetet financuan organizatat e tyre të preferuara (66%).

Përsa i përket organizatave që nuk aplikuan për fonde publike, 60% e tyre thanë se ata nuk mendojnë se kishin ndonjë mundësi reale për të fituar, 17% thanë se nuk kishin nevojë për financim publik dhe 13% thanë se fondet e ofruara ishin shumë të vogla. Disa arsye të tjera të përmendura për mos-aplikim për fonde ishin

- Për të fituar duhet të kesh një lidhje politike;
- Ka mungesë informacioni lidhur me fondet publike;
- Nuk ka besim se procedurat e përzgjedhjes janë të drejta.

OS 1.8. Individët dhe biznesi gëzojnë lehtësira fiskale për donacionet e tyre për OSHC-të.

Treguesi 1.8.a: Legjislacioni mbi taksat lejon për lehtësira fiskale lidhur me:

- Donacionet individuale;
- Donacionet nga biznesi.

2 – plotëson standardet minimalisht

21-40

Nga 2020, Ligji që ofron nxitje për donacionet nga biznesi është Ligji No.7892/1994, "Për sponsorizimet", i amenduar. Ligji njih si shpenzime të zbritshme deri në 5% të fitimit përpara taksimit për shtypin, botuesit dhe botuesit e literaturës shkencore dhe enciklopedike dhe, për aktivitetet kulturore dhe artistike, deri në 3% përpara taksimit. Krahasuar me 2020, në 2021 nuk ka ndryshime në kuadrin ligjor lidhur me nxitjen e donacioneve nga individët dhe biznesi.

Sipas Ligjit No. 79/2019, 'Mbi tatimin mbi të ardhurat', amenduar nga parlamenti shqiptar dhe aplikuar në 2020, asetet e dhëna nga biznesi që kualifikohen për zbritje nga tatimi janë pasuritë monetare dhe të paluejtshme deri në 5% të fitimit para taksimit në rastet kur është shpallur një "fatkeqësi natyrore". Sidoqoftë, këto donacione kualifikohen për zbritje vetëm kur disbursohen në Zyrën e Thesarit¹³.

Lidhur me donacionet nga individët, ligjet ekzistuese nuk i njohin si të zbritshme nga taksat për qëllimet e tatimit mbi të ardhurat personale.

Treguesi 1.8.b: Pjesa e individëve privat që kanë dhënë para tek një OSHC.

Bazuar në Raportin e CAF të 2021¹⁴, Shqipëria është e 49-ta nga 114 vende të vlerësuara lidhur me përqindjen e njerëzve që japin para, dhe që ishte 31%. Sidoqoftë, një përmirësim i vogël vihet re lidhur me të dhënat e viteve të mëparshëm. Kështu, në 2019, donacionet ishin 21% dhe në 2018 ishin 28%, Nuk ka të dhëna për vitin 2020¹⁵.

13 Vlerësimi i Gjendjes së Mjedisit Mundësues dhe Kapaciteteve të Shoqërisë Civile kundrejt Udhëzimeve 2014-2020 për Mbështetjen e BE-së për Shoqërinë Civile në Rajonin e Zgjerimit për vitin 2020. EU TA OSHC. Shkup, Shtator 2021, fq. 45.

14 CAF Report 2021 <https://good2give.ngo/wp-content/uploads/2021/06/caf-world-giving-index-2021.pdf> aksesuar më 7 Nëntor 2022.

15 CAF Reports [https://www.cafamerica.org/world-giving-index/#:~:text=More%20than%20half%20\(55%25\),unchanged%20at%20the%20global%20level](https://www.cafamerica.org/world-giving-index/#:~:text=More%20than%20half%20(55%25),unchanged%20at%20the%20global%20level) aksesuar më 7 Nëntor 2022.

OS 1.9. Ka lehtësira fiskale për OSHC-të.

Treguesi 1.9.a Masa në të cilën ligjet mbi taksat ofrojnë si më poshtë:

- Të ardhurat e gjeneruara nga OSHC-të nga grantet, donacionet, dhe anëtarësia, nga veprimtaria ekonomike, investimet, pasuritë, dhuratat dhe trashëgimia nuk janë subjekt i taksimit;
- Çdo e ardhur ose fitim shtesë të gjeneruara nga aktiviteti ekonomik dhe të përdorura nga OSHC-të për qëllime që lidhen me misionin nuk janë subjekt i taksës të të ardhurave/fitimit të biznesit.

4 – plotëson shumicën e standardeve

61-80

Bazuar në llojin e organizatës, fushën dhe ushtrimin e aktivitetit, OSHC-të përjashtohen nga taksa mbi të ardhurat për grantet, donacionet dhe kuotat e anëtarësisë, me kushtin që pasuria ose fitimi nuk përdoren për përfitimin e themeluesve apo anëtarëve.

Më tej, OSHC-të lejohen të angazhohen në veprimtari ekonomike. Kështu, OSHC-të janë qartësisht të lejuara të gjenerojnë të ardhura nga asetet e tyre nëpërmjet investimeve, qeradhënies dhe shitjes së pasurisë. Sidoqoftë, në këto raste, rregullat financiare nuk bëjnë dallim midis OSHC-ve dhe biznesit. Për rrjedhojë, OSHC-të janë përgjegjëse për taksën mbi fitimin për të gjithë të ardhurat nga aktiviteti ekonomik njëloj sikurse subjektet e tjera ligjore.

OS 1.10. Politikat dhe mjedisi ligjor ofrojnë incentiva dhe lehtësojnë vullnetarizmin dhe punësimin në OSHC

Treguesi 1.10.a: Janë adoptuar ligje që rregullojnë vullnetarizmin.

2 – plotëson standardet minimalisht | 21-40

Në Prill 2016, parlamenti shqiptar ka aprovuar Ligjin 45, “Për vullnetarizmin”. Ligji synon të përcaktojë parimet bazë, kushtet dhe kriteret për punën vullnetare. Ligji 45/2016 gjithashtu synon të nxisë angazhimin qytetar dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në zhvillimin e komunitetit. Kuadri ligjor mbi vullnetarizmin është kompletuar me aktet nën-ligjore. Gjithashtu, ka një Kod Etike për vullnetarët, Regjistër të Vullnetarëve dhe Manual të Vullnetarëve.

Sidoqoftë, në 2021, OSHC-të dhe institucionet publike u përballën me vështirësi në zbatimin e Ligjit “Për vullnetarizmin”. Kuadri ligjor nuk ofron një mjedis mundësues për OSHC-të që të fokusohen tek dhe të punojnë me vullnetarët. Ligji është më shumë një pengesë se sa një kuadër mundësues

Treguesi 1.10.b: Strategjitë dhe programet e qeverisë për vullnetarizimin mbështesin vullnetarizmin tek OSHC-të dhe kanë përcaktuar burime të mjaftueshme për zbatimin.

1 – nuk i plotëson standardet | 0-20

Në 2021 nuk ka as strategji dhe as programe për vullnetarizmin në Shqipëri.

Treguesi 1.10.c: Pjesa e OSHC-ve që përfitojnë nga strategjitë dhe programet shtetërore të punësimit.

Sipas rezultateve të anketës me OSHC-të, 90% e tyre thanë se ata nuk përfituan nga strategjitë dhe programet shtetërore mbi punësimin. Nga ana tjetër, 6% thanë se kanë përfituar nga strategjia shtetërore e punësimit. Ata që kanë përfituar përmendën se, ata kanë një marrëveshje me Agjensinë Kombëtare të Punësimit për punësimin e punëkërkuesve të papunë.

I njejtë rezultat është lidhur me përfitimet nga mbështetja për punësim e qeverisë e lidhur me COVID-in. Shumica e të anketuarve - 90% - konfirmuan se ata nuk kanë përfituar nga politikat e qeverisë.

Treguesi 1.10.d: Pjesa e OSHC-ve që përfitojnë nga strategjitë dhe programet shtetërore të vullnetarizmit.

Nuk ka një strategji ose program shtetëror të vullnetarizmit për Shqipërinë gjatë periudhës së raportimit. Kjo është konfirmuar edhe nga përgjigjet e OSHC-ve, ku 95% e respondentëve thanë ‘Jo’, nuk kanë përfituar.

Treguesi 1.10.e: Pjesa e të punësuarve në OSHC-të në numrin e përgjithshëm të të punësuarve.

INSTAT (Instituti i Statistikave) raportoi në 2021 që numri total i të punësuarve ishte **1,426,737**¹⁶ dhe, sipas Anketës së Fuqisë Punëtore, ishin **1,264,384** të punësuar në të gjithë vendin, por pothuaj gjysma e tyre - 44% - ishin të punësuar në sektorët e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit¹⁷. Numri i personave të punësuar në sektorin publik në 2021 ishte 183,255 dhe në sektorin privat 519,867¹⁸.

Lidhur me shoqërinë civile, nuk ka ndryshime në kuadrin ligjor mbi punësimin në OSHC-të. Sipas informacionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave, janë **9,872** punonjës në sektorin e SHC në 2021. Numri i punonjësve tregon stanjacion, megjithëse në 2021 ishin 230 punonjës të rinj të OJF-ve të regjistruar në

16 <https://www.instat.gov.al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/pun%C3%ABsimi-dhe-papun%C3%ABsia/#tab4>

17 http://www.instat.gov.al/http://databaza.instat.gov.al/pweb/sq/DST/START_TP_AD_ADY/ADY03/table/tableViewLayout1/

18 Open Data Albania <https://ndiqparate.al/?p=13343> aksesuar më 8 Nëntor 2021

zyrën e taksave¹⁹. Kështu, pjesa e punonjësve në OSHC-të në raport me numrin total të fuqisë punëtore ishte 0.69%, dhe pjesa e punonjësve në OSHC-të në raport me numrin e përgjithshëm të punonjësve ishte 0.78%

■ **Treguesi 1.10.f: Përqindja e njerëzve që kanë qenë vullnetarë në një organizatë.**

Sipas Raportit të CAF 2021²⁰, përqindja e njerëzve që kanë qenë vullnetarë në Shqipëri në 2021 ishte 11%. Kjo përqindje vullnetarizmi ishte pak më e lartë se ajo e shumicës së viteve parardhëse: në 2018 ishte 7% dhe në 2019 ishte 9%. Nuk ka të dhëna për vitin 2020. Është e dukshme që, megjithë barrierat e krijuara nga pandemia, për shumë nga aktivitetet e vullnetarizmit ka një trend pozitiv lidhur me vullnetarizmin në Shqipëri.

19 *Matrica e monitorimit mbi mjedisin mundësues për zhvillimin e OSHC-ve*, Informacion mbi Shqipërinë, 2021, Partners Albania, Tiranë, Qershor 2022.

20 CAF Report 2021 <https://good2give.ngo/wp-content/uploads/2021/06/caf-world-giving-index-2021.pdf> aksesuar më 7 Nëntor 2022.



Objektivi Specifik 2

Bashkëpunim dhe partneritet i fuqizuar midis OSHC-ve dhe institucioneve publike.

OS 2.1. Autoritetet dhe institucionet publike përfshijnë OSHC-të në proceset vendim-marrëse dhe politikë-bërëse.

Treguesi 2.1.a: Ligjet, aktet nën-ligjore, strategjitë dhe aktet e tjera të interesit publik dhe reformat e politikave janë konsultuar efektivisht me OSHC-të:

- OSHC-të kanë akses në draft-dokumentet që nga fillimi i procesit të përgatitjes deri në fund të procedurës së adoptimit;
- Të paktën 15 ditë janë lënë për komentim përpara se draft-dokumenti të kalojë në procedurat e adoptimit;
- Përdorimi i procedurave të jashtëzakonshme/përshpejtuara për adoptimin e legjislacionit pa mundësinë e konsultimit është një përjashtim dhe i justifikuar siç duhet;
- Raportet mbi rezultatet e konsultimeve publike, përfshirë arsyet për mos-marrjen parasysh të komenteve, janë publikuar në kohë;
- Anëtarët e grupeve të punës nga OSHC-të janë përzgjedhur bazuar në një thirrje publike, kritere të qarta dhe barazinë;
- Anëtarët e grupeve të punës nga OSHC-të përfshijnë përfaqësues të shoqërisë si e tërë, përfshirë grupet e grave, LGBTQIA, migrantëve, minoriteteve, pa-afëtisë dhe të tjerë, në përputhje me Qasjen e Bazuar në të Drejtat e Njeriut.

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar 44%

Ka një set ligjesh dhe aktesh nën-ligjore që rregullojnë pjesëmarrjen e OSHC-ve dhe qytetarëve në proceset e politikë-bërjes dhe vendim-marrjes. Një nga këta është Ligji No.107/2021, “Për bashkëqeverisjen”²¹, i cili synon të krijojë kushtet dhe inkurajon ndërveprimin midis administratës shtetërore dhe individëve, personave fizik dhe juridik, dhe grupeve të interesit, pavarësisht formës së tyre të organizimit, me synim rritjen e rolit të tyre, përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike, si dhe ndërmarrjen e iniciativave, projekteve ose programeve. Përfshirja e qytetarëve në bashkëqeverisje është promovuar nëpërmjet platformës “Së bashku për Shqipërinë që duam”. Grupet e interesit kanë 20 ditë pune në dispozicion që të dërgojnë kontributin/komentet e tyre. Gjithashtu, për akte veçanërisht komplekse dhe të rëndësishme, në përputhje me vendimin e institucionit publik, afati për dërgimin e komenteve mund të zgjatet në 40 ditë pune nga data e lajmërimit.

Më tej, në përputhje me kërkesat e Ligjit, draft-aktet shoqërohen me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar. Nëse rekomandimet e palëve të interesuara nuk pranohen, atëherë institucioni publik paraqet një përmbledhje të arsyeve për mos-pranimin e tyre në një nga format e lajmërimit.

Përdorimi i procedurave të jashtëzakonshme/përshpejtuara për adoptimin e legjislacionit pa mundësinë e konsultimit është aplikuar për 220 akte nga 303 të aprovuara në total (sipas Raportit Vjetor të Performancës së Konsultimit Publik²², duke ju referuar Programit Analitik Vjetor). Indeksi i konsultimit është një Tregues që mat frekuencën e përdorimit të përjashtimit nga konsultimi publik (kriteri i përjashtimit i përmendur në Nenin 4 të Ligjit “Për informimin dhe konsultimin publik”) për aktet e përfshira në planin legjislativ vjetor të qeverisë (Programi Analitik). Treguesi i Përdorimit të Përjashtimit nga Konsultimi Pub-

²¹ <http://www.garda.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/Liqi-nr.-107-dt.-4.11.2021.Per-bashkeqeverisjen.pdf>

²² Raporti_Vjetor_Performances_Konsultimit_Publik_25022022. Zyra e Kryeministrit, Qendra për Qeverisje, f.7.

lik për aktet në programin e përgjithshëm analitik ishte 72.6%. Krahasuar me 2020 (88.68%), ka një ulje në aktet që janë subjekt i kriterit të përjashtimit me 16%.

Bazuar në rezultatet e anketës së OSHC-ve, 44% e të anketuarve thanë se autoritetet u konsultuan efektivisht me organizatën e tyre në draftimin e ligjeve, akteve nën-ligjore, strategjive, ose akteve të interesit publik dhe reformave të politikave. Nga ana tjetër, 47% e OSHC-ve thanë se autoritetet nuk u konsultuan me ta.

Më tej, 24% e të anketuarve thanë se organizata e tyre ka patur akses në draft-dokument nga fillimi i procesit të draftimit deri në fund të procedurës së adoptimit. E njehta përqindje e OSHC-ve (24%) thanë se organizata e tyre kishte të paktën 15 ditë në dispozicion për komente përpara se draft-dokumenti të hynte në procedurën e adoptimit.

18% e të anketuarve thanë se një përfaqësues i organizatës së tyre ishte anëtar i një grupi pune për zhvillimin e ligjeve, akteve nën-ligjore, akteve nën-ligjore, strategjive, ose akteve të interesit publik dhe reformave të politikave.

Treguesi 2.1.b: OSHC-të janë përfshirë efektivisht në mekanizmat mbykqyrës.

Bazuar në anketën për autoritetet publike, pothuaj gjysma e të anketuarve thanë se OSHC-të janë përfshirë efektivisht në mekanizmat shtetëror që mbikqyrin zbatimin e politikave publike.

Gjithashtu, disa gjetje që japin një ide rreth përfshirjes së qytetarëve/OSHC-ve në mekanizmat e mbikqyrjes mund të nxirren nga Raporti mbi Anketën e Opinionit Publik të realizuar nga IDM. Kështu, shumica e qytetarëve shqiptar (72.2%) raportuan mundësi të pamjaftueshme për të marrë pjesë në procesin e vendim-marrjes së institucioneve publike. Në 2021, u rrit ndërgjegjësimi i institucioneve publike për mekanizmat që e vënë qeverinë para përgjegjesisë. Në përfundim, shqiptarët besojnë se organizatat ndërkombëtare (77%) e vënë qeverinë para përgjegjesisë më mirë se organizatat vendase²³.

Treguesi 2.1.c: Pjesa e OSHC-ve që kanë marrë pjesë në konsultime gjatë përgatitjes së raporteve shtetërore në kuadrin e detyrimeve ndërkombëtare dhe të tjera lidhur me të drejtat e njeriut dhe zbatimin e rekomandimeve të tyre.

Sipas rezultateve të anketës për OSHC-të, më pak se gjysma e të anketuarve (42%), dinin rreth thirrjeve të hapura për përgatitjen e raporteve qeveritare nën konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe konventa të tjera ose zbatimin e konventave. Një përgjigje negative është dhënë nga 32% e të anketuarve.

Njëkohësisht, 23% e atyre që thanë se qeveria ka nxjerrë thirrje të hapura për pjesëmarrjen e OSHC-ve në konsultime kanë marrë pjesë në proceset e konsultimit.

Bazuar në inputet e dhëna gjatë takimit konsultues dhe validues për vlerësimin e indikatorëve, bashkëpunimi me institucionet publike qendrore dhe lokale është i vështirë. Në këtë kontekst, ia vlen të përmendet procesi i dhënies së opinionit nga institucionet publike mbi komentet dhe sugjerimet e dhëna nga OSHC-të gjatë sesioneve të konsultimit. Shumë rrallë ka pasur ndonjë proces raportimi mbi çfarë ndodhi me kontributet e dhëna nga OSHC-të.

23 Trust in Governance 2021, Survey Report, Institute for Democracy and Mediation Albania/IDM.

OS 2.2. Autoritetet dhe institucionet publike pranojnë rëndësinë e shoqërisë civile në debatin shoqëror mbi politikat dhe proceset e integritimit në BE.

Treguesi 2.2.a: Masa në të cilën OSHC-të vlerësojnë si mbështetës qëndrimin e zyrtarëve publik kundrejt shoqërisë civile.

2 – plotëson standardet minimalisht 34%

Gjatë viteve të fundit, qëndrimi i zyrtarëve publik kundrejt shoqërisë civile ka ndryshuar. Ka mendime të ndryshme lidhur me këtë, por sipas Anketës së OSHC-ve, në 2021 vetëm 34% e të anketuarve e perceptojnë qëndrimin e zyrtarëve publik si mjaftueshëm mbështetës ose plotësisht mbështetës. Shumica e përgjigjeve - 55% - janë në grupin që mendon se qëndrimi i zyrtarëve publik nuk është aspak mbështetës ose është pa-mjaftueshmërisht mbështetës.

OS 2.3. Autoritetet publike kontribuojnë në fuqizimin e shoqërisë civile duke bashkëpunuar me shoqërinë civile nëpërmjet kuadrit strategjik të politikave dhe mekanizmave të duhur institucional.

Treguesi 2.3.a: Pjesa e OSHC-ve që janë konsultuar efektivisht gjatë përgatitjes së strategjive të bashkëpunimit me shoqërinë civile.

Strategjia kryesore për bashkëpunimin midis shoqërisë civile dhe qeverisë në Shqipëri është “Udhërrëfyesi për politikën qeverisëse drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019–2023”. Bazuar në rezultatet e anketës së OSHC-ve, 52% e të anketuarve thanë se strategjia është përgatitur nëpërmjet një procesi të konsultimit publik.

Analiza e mëtejshme e përgjigjeve të dhëna nga organizatat që janë konsultuar gjatë procesit të zhvillimit të strategjisë, tregon që shumica e përgjigjeve – rreth 46% - thanë që procesi i konsultimeve nuk ishte aspak efektiv ose ishte jo mjaftueshëm efektiv. Ndërsa, përgjigje pozitive është dhënë nga 39% e organizatave, të cilat pranojnë se procesi i konsultimit ka qenë mjaftueshëm efektiv ose plotësisht efektiv.

Gjithashtu, gjatë diskutimeve në grupin fokus, pjesëmarrësit e konsideruan rezultatin e anketës së OSHC-ve të saktë. Përshtypja ishte se procesi i konsultimit është bërë vetëm për të qenë në rregull me detyrimet ligjore dhe për të bindur komunitetin ndërkombëtar se qeveria po përfshin OSHC-të në procesin e zhvillimit të strategjisë. Në fakt, mendimi i OSHC-ve nuk është reflektuar siç duhet në Udhërrëfyesin për shoqërinë civile dhe qeveria nuk dha ndonjë informacion lidhur me çfarë ndodhi me kontributin e dhënë nga shoqëria civile. Kështu, strategjia ishte më tepër një dokument se sa një strategji dhe nuk inspiroi pritshmëri të mëdha tek OSHC-të.

Treguesi 2.3.b: Përfituesit e IPA kanë adoptuar aktualisht strategji të vlefshme për bashkëpunimin me shoqërinë civile.

5 – plotëson të gjithë standardet 81–100

Fillimisht, strategjia për bashkëpunimin me shoqërinë civile në Shqipëri, “Udhërrëfyesi për Politikën Qeverisëse drejt një Mjedisi Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile”, është botuar në Gazetën Zyrtare në Maj 2015²⁴. Adoptimi i Udhërrëfyesit u parapri nga një konsultim i gjërë me përfaqësuesit e shoqërisë civile si dhe komunitetin e donatorëve. Gjithashtu, në 2014, Parlamenti Shqiptar miratoi një

²⁴ Udhërrëfyesi për politikën qeverisëse drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019–2023. Qeveria e Shqipërisë, 2019.

'Rezolutë për Njohjen dhe Fuqizimin e Rolit të Shoqërisë Civile' si një akt që mbështeti fuqimisht të gjithë aktet e tjera të ndërmarra nga Qeveria dhe Shoqëria Civile.

Versioni i rishikuar i Udhërrëfyesit 2019–2023 reflekton pikëpamjen e Qeverisë Shqiptare, bazuar në kontributin e Ministrive të Linjës përgjegjëse për veprime specifike të Udhërrëfyesit, AMSHC-së, Shoqërisë Civile nëpërmjet një ankete online të publikuar në faqen e AMSHC-së, anëtarët nga OSHC-të në Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile (KKSHC), dhe konsultimet individuale dhe në grup me përfaqësuesit e sektorit të shoqërisë civile.

Fokusi i Udhërrëfyesit është përcaktimi i veprimeve të nevojshme nga qeveria gjatë 2019 – 2023 për përmirësimin e mjedisit ku operon shoqëria civile. Më tej, ai identifikon institucionet publike të Qeverisë Shqiptare përgjegjëse për zbatimin e Udhërrëfyesit dhe përshkruan sistemin e monitorimit.

Treguesi 2.3.c: Strategjitë e bashkëpunimit me shoqërinë civile shoqërohen me plane veprime të buxhetuara..

1 – nuk i plotëson standardet

0–20

Në 2021 nuk kishte ndonjë plan veprimi vjetor që të tregonte qartë burimet për zbatimin e strategjisë së bashkëpunimit me shoqërinë civile/Udhërrëfyesin 2019–2023. Ministritë e ndryshme përgjegjëse për zbatimin e masave dhe veprimeve specifike të strategjisë nuk kanë publikuar buxhetet për këto masa. Kështu, tre vite pas aprovimit të Udhërrëfyesit të rishikuar, është vënë re një përparim shumë i vogël në zbatimin e masave të tij. Pothuaj asnjë nga veprimet dhe masat e planifikuara për tu realizuar deri në fund të vitit 2021 nuk janë zbatuar, pa mohuar zbatimin pjesor të pak veprimeve; dhe nuk ka ndonjë raport mbi monitorimin e vlerësimin e përparimit në zbatimin e Udhërrëfyesit²⁵.

Në qershor 2021, AMSHC organizoi një takim me OJF-të për të diskutuar zbatimin e Udhërrëfyesit, por nuk u pregatit ndonjë raport për këtë dhe as nuk u ndërmorr ndonjë veprim.

Treguesi 2.3.d: Pjesa e OSHC-ve që vlerësojnë strategjitë e bashkëpunimit me shoqërinë civile si relevante dhe efektive.

Strategjia e bashkëpunimit me shoqërinë civile në Shqipëri —“Udhërrëfyesi për Politikën Qeverisëse drejt një Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile”— konsiderohet nga zyrtarët publik që u kontaktuan si mjaftueshëm relevante ose shumë relevante, dhe 80% e tyre thanë se strategjia është efektive.

Sidoqoftë, rezultatet ishin të ndryshme nga anketa e OSHC-ve. Aty, 40% e OSHC-ve thanë se ata konsiderojnë strategjinë e bashkëpunimit me shoqërinë civile aspak ose jo-mjaftueshëm relevante/efektive, megjithëse 48% thanë se ata e konsiderojnë strategjinë mjaftueshëm ose shumë relevante/efektive.

Treguesi 2.3.e: Strukturave publike, përgjegjëse për zbatimin e strategjive të bashkëpunimit me shoqërinë civile, iu janë dhënë burimet e duhura.

Institucionet kryesore qeveritare të përfshira në mekanizmat OSHC – qeveri janë:

- Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC), i cili është krijuar në 2016 si një institucion konsultativ i pavarur, kolegjal që synon të garantojë bashkëpunimin institucional midis shtetit dhe OJF-ve. Në 2021, ai ka qenë pothuaj inaktiv. Është mbajtur vetëm një takim online.
- Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), e cila është një agjensi shtetërore e rregulluar nga Ligji No. 10093/2009. AMSHC shërben si sekretariat i KKSHC. Këshilli i Ministrave cakton organin e saj qeverisës. Me ligj, Bordi i AMSHC-së përbëhet nga katër anëtarë nga institucionet shtetërore të administratës publike qendrore dhe pesë anëtarë nga shoqëria civile. Një nga funksionet e saj kryesore është shpërndarja e granteve për OSHC-të, bazuar në thirrjet për propozime. Fondi për grantet vjen nga buxheti vjetor i shtetit. Ligji specifikon që shteti nuk mund t'i japë Agjencisë një buxhet më

25 Matrica e monitorimit mbi mjedisin mundësues për zhvillimin e OSHC-ve, Partners Albania, Tiranë, f.18, Qershor 2022

të vogël se buxheti i vitit paraardhës. Buxheti i shtetit mbulon edhe shpenzimet administrative të Agjencisë nëpërmjet një linje të veçantë buxhetore si dhe mjediset për aktivitetin e saj. Në 'Matricën e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e OSHC-ve', Informacion mbi Shqipërinë, 2021', financimi nga shteti për AMSHC-në ishte 90 milion lekë (afërsisht 744,000 euro).

- Ministritë e Linjës luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e Udhërrëfyesit. Ku është e mundur, në Ministritë e Linjës dhe institucionet e tjera qeveritare janë caktuar koordinatorët për bashkëpunimin me OSHC-të. Ministritë e Linjës kanë një buxhet të caktuar për zbatimin e strategjisë, i cili nuk është bërë publik për qytetarët dhe OSHC-të.

Treguesi 2.3.f: Mekanizmat për dialog midis këshillave të bashkëpunimit të shoqërisë civile dhe qeverisë qendrore përfshijnë OSHC-të në një mënyrë kuptimplotë:

- Ata kanë një program pune të dakortësuar;
- Ata kanë rënë dakort për rregullat dhe procedurat;
- Ata takohen rregullisht;
- Rregullat lejojnë OSHC-të të organizojnë takime dhe kontribuojnë në zhvillimin e axhendës;
- Ka një ndjekje të duhur të konkluzioneve dhe rekomandimeve.

4 – plotëson shumicën e standardeve

61-80

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile/KKSHC është instrumenti kryesor për dialog dhe konsultim midis Qeverisë së Shqipërisë dhe shoqërisë civile. KKSHC vepron si një organ këshillues për Qeverinë Shqiptare lidhur me çështjet e zhvillimit të shoqërisë civile, duke sjellë së bashku përfaqësuesit e organeve qeveritare përgjegjës për fushat kryesore të politikave që ndikojnë mbi OSHC-të si dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Këshilli operon bazuar në planin vjetor të punës (plani i parë vjetor është aprovuar në Mars 2019). Plani vjetor rishikohet çdo vit në përputhje me veprimet mbi të cilat është rënë dakort që të ndërmerren nga KKSHC dhe anëtarët e tij nga shteti dhe shoqëria civile dhe në kordinim më të madh me partnerët për zhvillim (ose Grupin Sektorial të Punës për Shoqërinë Civile) që janë të angazhuar në veprime të lidhura me strategjinë e "Udhërrëfyesit për Politikën Qeverisëse drejt një Mjedisit Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile". Nuk është përgatitur ndonjë plan vjetor për 2021. Faktikisht, në praktikë, nuk ka hapësirë të mjaftueshme për OSHC-të që të kontribuojnë në punën e Këshillit.

KKSHC ka rregulloren e tij të brendshme²⁶ që përcakton rregullat dhe procedurat për funksionimin e Këshillit. Kjo rregullore flet për numrin e takimeve, përgatitjen e axhendës, personat përgjegjës për proces-verbalin e takimeve dhe si qarkullohet proces-verbali i takimeve.

Për sa i përket ndjekjes së konkluzioneve dhe rekomandimeve, procesi se si duhet të kryhet mbetet i paqartë, me përjashtim të faktit se Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (organi ekzekutiv i KKSH) është përgjegjëse për ndarjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

26 <https://drive.google.com/file/d/1KY0yh1cbw8UP3fEgZW4U1nfjPW3B3oTz/view> aksesuar më 2 Dhjetor 2022 në faqen e internetit <https://amshc.gov.al/kkshc/>



Objektivi Specifik 3

Është përforcuar kapaciteti dhe aftësia e OSHC-ve për të realizuar me efektivitet aktivitetet.

OS 3.1. Strukturat e qeverisjes së brendshme të OSHC-ve bazohen në parimet e qeverisjes së mirë.

Treguesi 3.1.a: Pjesa e OSHC-ve që kanë një organ qeverisës të pavarur dhe efektiv, me terma të qarta reference, për mbikqyrjen e qëllimeve strategjike, ndikimit, menaxhimit, përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe llogaridhënies së organizatës.

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar 54%

54% e të anketuarve thanë se ata kanë një organ qeverisës dhe një dokument qeverisës që përcakton qartë rolet dhe përgjegjësitë e organit qeverisës dhe nuk kanë anëtarë të stafit të paguar në bord.

OSHC-të raportojnë përputhshmëri pothuajse të plotë me kërkesën për të pasur një organ qeverisës me terma të qarta reference. 99% e tyre raportojnë se kanë një organ qeverisës; 100% raportojnë se kanë një dokument qeverisës, i cili në 98% të rasteve përcakton rolet dhe përgjegjësitë e organit qeverisës. Sidoqoftë, është shqetësuese që, lidhur me pavarësinë e organit qeverisës, 41% e të anketuarve raportuan se drejtori ekzekutiv ose një anëtar tjetër i paguar i stafit ishte anëtar me të drejtë vote i organit qeverisës.

Pjesëmarrësit në grupin fokus mendojnë se kjo gjetje e anketës së OSHC-ve është krejt realiste. Ata thanë se edhe pse ligji thekson se organi qeverisës (për fondacionet dhe qendrat) është i ndarë nga stafi ekzekutiv i OSHC-ve, në disa raste drejtori ekzekutiv merr pjesë në organet qeverisëse. Kjo është një praktikë e përmendur pothuajse nga të gjithë pjesëmarrësit në grupin fokus. Ata thanë që në disa raste organizatat e vogla dhe që operojnë bazuar në projekte hasin vështirësi që të gjejnë anëtarë të përhershëm për asambletë/bordet e tyre dhe, për rrjedhojë, ata marrin pjesë në takimet e organeve qeverisëse si anëtar.

Sidoqoftë, u përmende se për organizatat e regjistruara si shoqatë është normale që drejtori ekzekutiv të jetë anëtar i asamblesë sepse kjo është shkruar në ligj. Kështu, është thënë që drejtori ekzekutiv është pjesë e asamblesë e cila është organi më i lartë i shoqatës dhe ai/ajo mund të ketë të drejtën e votës për vendimet që nuk janë të lidhura me menaxhimin nën përgjegjësinë e tij/saj, si për shembull aprovimi i raporteve financiare.

Treguesi 3.1.b: Pjesa e OSHC-ve që në mënyrë të rregullt shqyrtojnë konfliktin e interesit lidhur me marrëdhëniet politike, ekonomike dhe personale të organit të tyre qeverisës.

1 – nuk i plotëson standardet 20%

Situata është krejt sfiduese lidhur me konfliktin potencial të interesit të anëtarëve të organit qeverisës. Vetëm 20% e OSHC-ve kërkojnë që një deklaratë mbi konfliktin e interesit të nënshkruhet çdo vit nga anëtarët e organit qeverisës, megjithëse 38% kërkojnë që një deklaratë të nënshkruhet me pranimin si anëtar por që nuk kontrollohet në intervale të rregullta.

Treguesi 3.1.c: Pjesa e OSHC-ve që ndajnë informacionin e duhur mbi organizatën nëpërmjet mjeteve dhe kanaleve që janë të aksesueshme nga të gjithë palët e interesuara përsa i përket publikimit të:

- statuteve;
- strukturës qeverisëse;
- politikave organizative.

2 – plotëson standardet minimalisht 23%

Bazuar në anketën e OSHC-ve, 23% e të anketuarve thanë që ata publikojnë i) dokumentet e tyre qeverisëse në faqen e internetit, ii) ose strukturën organizative, anëtarët, ose të dyja, dhe iii) kanë publikuar të paktën një politikë organizative.

Vetëm 38% e OSHC-ve publikojnë dokumentet e tyre qeverisëse në faqen e internetit. Më pak se gjysma e të anketuarve thanë që organizata e tyre ndan informacionin me të gjithë palët e interesuara duke publikuar strukturën organizative (42%), ndërsa 22% thanë se ata publikojnë informacionin mbi anëtarët e bordit. Nga këta, vetëm 15% publikojnë informacionin mbi të dyja, strukturën organizative dhe anëtarët e bordit.

Treguesi 3.1.d: Pjesa e OSHC-ve që kanë një politikë organizative të barazisë gjinore.

3 – plotëson standardet në mënyrë të moderuar 56%

Shumica e OSHC-ve tregojnë kujdes për barazinë gjinore, çfarë tregohet nga përqindja e lartë e organizatave që u përgjigjën se ata kanë një politikë të barazisë gjinore. Kështu, në Shqipëri, 56% e të anketuarve kanë një politikë të barazisë gjinore.

Treguesi 3.1.e: Pjesa e OSHC-ve që kanë strategji organizative, përfshirë vizion, mision dhe qëllime.

4 – plotëson shumicën e standardeve 63%

Anketa e OSHC-ve tregon që 63% e OSHC-ve kanë një strategji dhe strategjia artikulon të paktën një: vizionin, misionin apo qëllimet. Ky rezultat tregon se OSHC-të kuptojnë rëndësinë e një dokumenti strategjik në mënyrë që të planifikohet dhe organizohet siç duhet puna e organizatës.

OS 3.2. OSHC-të janë të afta të komunikojnë rezultatet e aktiviteteve të tyre tek publiku.

Treguesi 3.2.a: Pjesa e OSHC-ve që kanë të paktën një kanal on-line komunikimi.

5 – plotëson të gjithë standardet 97%

Bazuar në anketën e OSHC-ve, 97% e respondentëve kanë të paktën një kanal komunikimi on-line. Faqet e internetit dhe mediat sociale janë kanalet më të zakonshme që përdoren nga OSHC-të për të komunikuar aktivitetet e tyre tek publiku. Kështu, Facebook përdoret nga 93% e OSHC-ve, i ndjekur nga faqja e internetit me 64%, dhe Instagram me 60%.

Twitter është më pak i përdoruri, me 24% të të anketuarve, dhe email me 2.6%

Treguesi 3.2.b: Pjesa e OSHC-ve që kanë staf të specializuar për komunikimin.

Rezultati për këtë tregues ishte që 65% e OSHC-ve kanë një anëtar stafi që është përgjegjës për komunikimin e jashtëm me palët e interesuara. Nga ana tjetër, 34% e OSHC-ve thanë se nuk kanë një person të caktuar përgjegjës për komunikimin.

Treguesi 3.2.c: Pjesa e OSHC-ve që bashkëpunojnë me median.

37% e respondentëve thanë se bashkëpunojnë me median.

OS 3.3. OSHC-të janë transparente rreth aktiviteteve të programeve dhe burimet e financimit.

Treguesi 3.3.a: Pjesa e OSHC-ve që publikojnë raportet e tyre vjetore dhe bilanci financiar.

2 – plotëson standardet minimalisht 29%

Një numër i vogël i OSHC-ve – rreth 29% - thanë se ata publikojnë të dyja, raportet vjetore dhe bilanci financiar. Raportet vjetore janë dokumentet që publikohen më shpesh. Kështu, 43% e OSHC-ve thanë që ata publikojnë vetëm raportin vjetor. E njëjta përqindje (43%) thanë që publikojnë vetëm bilanci financiar.

35% e atyre që thanë se publikojnë të dyja, raportin vjetor dhe bilanci financiar përdorin kopje të printuara. Vetëm 21% e OSHC-ve u përgjigjën që i vendosin ato në faqen e internetit.

Gjithashtu, të gjithë OSHC-të e intervistuar pohuan se kanë dërguar bilanci tek Zyra e Taksave rregullisht, sikurse kërkohet me ligj. Sidoqoftë, OSHC-të me asete ose të ardhura mbi 30 milion lekë (rreth 241,000 EURO) duhet të publikojnë bilanci vjetor financiar në faqen e internetit. Ata gjithashtu duhet të pregatisin një raport narrativ dhe ta publikojnë atë së bashku me bilanci vjetor financiar.

Treguesi 3.3.b: Pjesa e OSHC-ve që publikojnë informacionin mbi burimet e financimit dhe shumën e marra në vitin paraardhës.

2 – plotëson standardet minimalisht 23%

Bazuar në anketën e OSHC-ve, 23% e të anketuarve thanë se ata publikojnë të dyja, burimin dhe shumën e financimit. Gjithashtu lidhur me këtë tregues, u dhanë këto përgjigje: 36% e OSHC-ve nuk publikojnë informacion as mbi burimin e financimit dhe as mbi shumën e marrë, 53% thanë se nuk publikojnë burimet e financimit dhe 25% se nuk publikojnë shumën e marrë.

Disa nga arsyet e përmendura për mos-publikimin e burimit të financimit ose shumës së marrë ishin: nuk është konsideruar e nevojshme që të bëhet kjo për publikun e gjërë; disa OSHC lokale nuk kishin ndonjë financim (në 2021); dhe disa organizata zakonisht e dërgojnë këtë informacion tek donatorët e tyre respektiv.

Një nga arsyet e përmendura për mos-publikimin e burimit të financimit dhe shumës së marrë në grupin fokus ishte se shumica e organizatave të vogla nuk kanë një faqe interneti të përditësuar, sepse ata nuk kanë staf të dedikuar për komunikimin dhe mirëmbajtjen e faqes/mediave sociale. Një arsye tjetër ishte se disa OSHC kanë pasur pak ose aspak fonde dhe, për rrjedhojë, ata hezitojnë të bëjnë publik këtë informacion. Gjithashtu, është thënë se nuk është pjesë e kulturës së brendshme të OSHC-ve të publikojnë fondet dhe burimet e financimit, sepse ata e konsiderojnë më të rëndësishme transparencën kundrejt donatorëve dhe zyrës së taksave. Kështu, ata e konsiderojnë raportimin dhe transparencën me donatorët dhe zyrën e taksave të mjaftueshme përse i përket transparencës dhe llogaridhënies.

Treguesi 3.3.c Shkalla e besimit publik në OSHC-të..

Nuk ka të dhëna për 2021.

OS 3.4. OSHC-të monitorojnë dhe vlerësojnë rezultatet dhe ndikimin e punës së tyre.

Treguesi 3.4.a: Pjesa e OSHC-ve që kanë bërë një vlerësim të punës së tyre vitin e kaluar.

4 – plotëson shumicën e standardeve | 82%

82% e OSHC-ve të anketuara kanë bërë të paktën një vlerësim. Më tej, duke iu referuar rezultateve të anketës së OSHC-ve, 64% e të anketuarve thanë se monitorimi dhe vlerësimi në nivel projekti ishte më i zakonshmi. Kjo ka qenë në rradhë të parë për shkak të kërkesave të donatorëve. 44% thanë se është bërë monitorimi dhe vlerësimi i proceseve të brendshme.

OS 3.5. OSHC-të përdorin kërkimin dhe evidencën për të mbështetur punën e tyre.

Treguesi 3.5.a: Pjesa e OSHC-ve puna e të cilave është bazuar në evidencën e gjeneruar nëpërmjet hulumtimit.

5 – plotëson të gjithë standardet | 91%

91% e OSHC-ve të anketuara kanë aplikuar të paktën një formë hulumtimi. Mjetet e përdorura më shpesh nga OSHC-të për kërkimin e informacionit të nevojshëm për punën e tyre ishin (1) takimet e grupeve fokus, me 64% të të anketuarve; (2) kërkimi në zyrë, me 51% të të anketuarve; (3) konsultimi me komunitetin dhe anketimi, 47% e të anketuarve; dhe (4) kërkimi në terren, për 36% të OSHC-ve.

Mjetet më pak të përdorura janë (1) provat e rastësishme të kontrollit, me 10%; dhe (2) anketat e opinionit publik, me 20% të përgjigjeve.

Treguesi 3.5.b: Pjesa e OSHC-ve puna e të cilave mbështetet në konsultimin me njerëzit që kanë një interes në punën e tyre të tanishme ose të ardhshme.

5 – plotëson të gjithë standardet | 91%

91% e të anketuarve thanë se ata konsultohen me palët e interesuara kryesore. Anketa tregon se më shumë se gjysma e OSHC-ve përdorin shumë konsultimin - 64% e tyre me komunitetet lokale dhe 53% me autoritetet lokale. 44% e të anketuarve thanë se konsultohen me institucionet publike.

OS 3.6. OSHC-të punojnë në partneritete të drejta dhe të respektueshme për arritjen e qëllimeve të përbashkëta.

Treguesi 3.6.a: Pjesa e OSHC-ve që marrin pjesë në rrjetet lokale, qendrore dhe ndërkombëtare.

Anketa tregoi se 76% e OSHC-ve ishin të paktën anëtar të rrjeteve lokale, kombëtare ose ndërkombëtare. Kjo përqindje ndiqet nga 50% e OSHC-ve që marrin pjesë në rrjetet ndërkombëtare dhe pothuaj e njejta përqindje - 48% - në rrjetet formale. Përqindja më e ulët është për OSHC-të që marrin pjesë në rrjete lokale, me 18%.

Treguesi 3.6.b: Pjesa e OSHC-ve të angazhuara në partneritete ndër-sektoriale me akademinë, partnerët social dhe sektorin privat.

Lidhur me partneritetet ndër-sektoriale, OSHC-të përgjigjen se akademia është partneri më i shpeshtë, në 53% të rasteve. 26% thanë se janë angazhuar në partneritete me sektorin privat.

OS 3.7. OSHC-të kanë një financim të diversifikuar.

Treguesi 3.7.a: Pjesa e OSHC-ve që kanë donatorë të ndryshëm.

4 – plotëson shumicën e standardeve 63%

Bazuar në anketën e OSHC-ve, 63% e OSHC-ve kanë një financim të diversifikuar. Burimet kryesore të financimit të OSHC-ve në Shqipëri janë fondacionet private të huaja dhe organizatat ndërkombëtare. Kështu, në 2021, 68% e të anketuarve morën fonde nga këto burime. Burimi i dytë i financimit ishte Komisioni Evropian, me 46% të OSHC-ve që marrin fonde nga ky burim. 43% e OSHC-ve gjithashtu kanë marrë fonde nga OKB, OSBE, dhe KiE. Vetëm 11% e OSHC-ve marrin fonde nga fondacionet private të vendit.

Treguesi 3.7.b: Pjesa e OSHC-ve që sigurojnë fonde nga burime të tjera përveç donatorëve, për shembull kuotat e anëtarësisë, donacionet individuale/nga biznesi dhe aktivitetet për gjenerimin e të ardhurave.

4 – plotëson shumicën e standardeve 69%

Në total, 69% e OSHC-ve sigurojnë fonde nga burime të tjera përveç donatorëve. Kështu, në 2021 në Shqipëri, 19% u përgjigjën nga kuotat e anëtarësisë, që mund të lidhet me marrëdhëniet e dobëta të OSHC-ve me grupin e tyre të synuar. 22% e OSHC-ve thanë se morën fonde nga donatorët individual dhe 13% thanë se morën fonde nga bizneset. Kështu, sigurimi i fondeve nga biznesi ishte përqindja më e ulët krahasuar me burimet e tjera. Më tej, 20% e OSHC-ve të anketuara thanë se kanë mobilizuar fonde nga aktiviteti i tyre i biznesit/ndërmarrjes sociale/ofrimi i shërbimeve. Lidhur me *crowdfunding*, 14% e OSHC-ve sigurojnë fonde nga ky burim, që është pak a shumë e njëjta përqindje si në rastin e biznesit.

OS 3.8. OSHC-të kanë burime njerëzore efektive, të fuqizuara dhe të zhvilluara.

Treguesi 3.8.a: Pjesa e OSHC-ve që kanë staf të punësuar.

Anketa tregon se 55% e organizatave kanë të punësuar 1-5 staf. Ka një përqindje të konsiderueshme të OSHC - 22% - që raportuan se kanë punësuar 11 ose më shumë staf. Përqindja më e ulët e OSHC-ve, rreth 11%, thanë se punësojnë 6-10 staf. Sidoqoftë, 13% e OSHC-ve raportuan se nuk kishin staf të paguar në 2021.

Treguesi 3.8.b: Pjesa e OSHC-ve që kanë politika organizative për burimet njerëzore.

1 – nuk i plotëson standardet 2%

Anketa propozon 9 tipe të politikave të burimeve njerëzore, përfshirë politikën e rekrutimit, vlerësimin të punës, disiplinës dhe shkurtimit nga puna. Vetëm 2% e OSHC-ve thanë se i kanë zhvilluar të nëntë tipet e politikave. Një numër i konsiderueshëm i OSHC-ve - rreth 24% - thanë se kanë zhvilluar një ose dy politika të burimeve njerëzore.

64% thanë se nuk kanë publikuar ndonjë nga politikat e përmendura më lart në faqen e internetit të organizatës. Vetëm 29% e OSHC-ve thanë se kanë publikuar politikat në faqen e internetit.

Treguesi 3.8.c: Pjesa e OSHC-ve që gjatë vitit të kaluar kanë publikuar vendet e lira për staf dhe vullnetarë.

Bazuar tek anketa, një numër i vogël i OSHC-ve (12%) nuk kanë publikuar vendet e lira. Nga 61% që kanë publikuar vendet e lira, shumica (60%) e kanë bërë nëpërmjet medias sociale si kanali kryesor i përdorur për këtë qëllim. Kanali i dytë më i përdorur ishte faqja e internetit e organizatës me 74%, e ndjekur nga

lista e adresave me 20%. Kanali më pak i përdorur për publikimin e vendeve të lira ishte media e shkruar, me 3%.

Treguesi 3.8.d: Pjesa e OSHC-ve që kanë politika organizative për rekrutimin e një fuqie punëtore të diversifikuar.

Një numër i konsiderueshëm i OSHC-ve - rreth 33% - kanë një politikë rekrutimi. Rëndësia e marrjes në punë të stafit të kualifikuar është shoqëruar edhe me rëndësinë e një kolektivi pune të diversifikuar. 37% e OSHC-ve thanë se kanë një politikë të diversitetit, barazisë dhe përfshirjes. Njëkohësisht, 25% e të anketuarve pohuan se kanë adoptuar të dy politikat e kërkuara, rekrutimin dhe diversitetin, barazinë dhe përfshirjen.

Treguesi 3.8.e: Pjesa e OSHC-ve ku stafi dhe vullnetarët kanë ndjekur një kurs trajnimi vitin e kaluar.

4 – plotëson shumicën e standardeve 73%

Shumica (73%) e OSHC-ve të anketuara u përgjigjën pozitivisht lidhur me pjesëmarrjen e stafit të tyre në kurse trajnimi. Kjo tregon rëndësinë e procesit të ndërtimit të kapaciteteve për OSHC-të. Supozimi është që OSHC-të po ofrojnë mundësi më të mëdha për stafin e tyre në mënyrë që të rriten njohuritë dhe aftësitë e tyre.

Në anketë, 25% e OSHC-ve thanë se stafi i tyre nuk ka marrë pjesë në ndonjë kurs trajnimi në 2021.

Bibliografia

- 'Udhërrëfytyesi për Politikën Qeverisëse drejt një Mjedisi Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile 2019–2023', Qeveria e Shqipërisë, Tiranë, 2019, f. 31.
- 'Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e OSHC-ve', Partners Albania, Tiranë, Qershor 2022
- 'Tabela-1-Buxheti-2021-institucionet-me-programe-dhe-shpenzimet-e tjera-1', Ministria e Financave, Tirana, 2021.
- 'Assessment of the State of the Enabling Environment and Capacities of Civil Shoqëri against the 2014–2020 Guidelines for EU Support to Civil Shoqëri in the Enlargement Region for the year 2020', EU TAOSHC, Skopje, September 2021, p. 45.
- CAF Report 2021
- Raporti Vjetor i Performances se Konsultimit Publik 25022022, Zyra e Kryeministrit, Qendra e Qeverisjes, Tiranë, 2022, f. 7.
- 'Trust in Governance 2021', Survey Report, Institute for Democracy and Mediation Albania/IDM, 2022.
- Vullnetarizmi në Shqipëri, Studim Kombëtar, Beyond Barriers Albania, Tirana, 2021

Lista e ligjeve të konsultuara

- Kushtetuta
- Kodi Civil
- Kodi Penal
- Ligji no. 8789, datë 7.5.2001 “Mbi regjistrimin e organizatave jo-fitimprurëse”
- Ligji no. 80/ 2021 “Mbi regjistrimin e organizatave jo-fitimprurëse”
- Ligji “Mbi organizimin dhe funksionimin e grupeve lokale të veprimit”
- Ligji no.8773, 2001 “Mbi grumbullimet”
- Ligji no.108/2014 “Mbi Policinë e Shtetit”
- Urdhër no. 633, datë 17.11.2020 “Mbi ndalimin e grumbullimeve në ambiente të hapura dhe të mbyllura”
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese no. 11, datë 09.03.2021
- Ligji no. 8239, datë 03.09.1997 “Për median”
- Ligji no.97/2013 “Për median audio-vizuale në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji no. 119/2014 “Mbi të drejtën e informimit”
- Vendim i Këshillit të Ministrave no. 512, datë 18.09.2021 “Mbi krijimin e Agjencisë së Medias dhe Informimit”
- Ligji “Mbi komunikimet elektronike”
- Ligji “Mbi padinë kolektive”
- Ligji no. 9754, datë 14.6.2007 “Mbi përgjegjësinë penale të personave juridik”
- Ligji no. 10 221, datë 04.02.2010 “Mbi mbrojtjen kundër diskriminimit”
- Ligji no. 9381, datë 28.04.2005 “Për kompensimin e burgimit të padrejtë”
- Ligji no. 9918, datë 19.5.2008 “Mbi komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji no. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”
- Ligji no. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, amenduar Ligji no.10 391, datë 3.3.2011; no. 66/2012, datë 7.6.2012; no. 44/2017, datë 6.4.2017; no. 33/2019, datë 17.6.2019, no.120/2021 datë 2.12.2021)
- Ligji no. 157/2013 “Mbi masat kundër financimit të terrorizmit”
- Ligji no. 95/2016 “Mbi organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”
- Ligji No. 10 192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”
- Ligji No. 112/2020 “Për regjistrimin e pronarëve përfitues”
- Ligji no. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”
- Ligji no. 72/2019 “Për masat shtërnguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji no.9917, datë 19.5.2008
- Ligji no. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë “
- Ligji no. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”
- Ligj no. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”
- Ligj no. 45/2016 “Për vullnetarizmin”
- Ligji no. 139/2015 “Për vetë-qeverisjen vendore”
- Ligji no.119/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile”

- Ligji no.107/2021 “Për bashkëqeverisjen”
- Vendim i Këshillit të Ministrave no. 539, datë 25.7.2019 “Për miratimin e udhërrëfyesit për politikën qeverisëse drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019–2023”
- Ligji no. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”
- Ligji “Për konfliktin e interesit”